


# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5450  
E premte, 13 prill 2018  
çmimi 0.40 €

## Kuvajti konfirmon mbështetjen për Kosovën

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### AKTUALE

**NË LUFTËN E KOSOVËS KISHTE VETËM NJË UÇK** F. 11



Jakup KRASNIQI

**NGRIHET AKTAKUZË PËR KORRUPTION NDAJ PAL LEKAJT** F. 7

**EDI RAMËS I HEDHIN MIELL NË KUVEND** F. 2

### EKONOMI

**'CHELSEA POINT' SJELL STILIN ANGLEZ TË JETESËS NË PRISHTINË** F. 9

**BSPK-JA PROTESTON MË 1 MAJ** F. 8

### KULTURË

**NJË VEPËR STUDIMORE QË E NDERON SHKENCËN E ALBANOLOGJISË**



Prof. dr. Emin KABASHI

F. 14

### SPORT

**DREJTUESIT E KOK-ut SOT VIZITOJNË GJILANIN DHE DARDANËN** F. 18

FLET PËR "EPOKËN E RE", FATMIR MATOSHI

FAQE 4-5

# AKR-ja e bëri këtë Qeveri dhe e shpëtoi pa rënë



Nënkryetari i Aleancës Kosova e Re (AKR), Fatmir Matoshi, ka thënë se kjo parti nuk ka qenë e kënaqur me kërkesën e kryeministrit Ramush Haradinaj për ta liruar Flamur Sefaj postin e ministrit të Punëve të Brendshme. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka

thënë se kjo kërkesë ishte e padrejtë. Pavarësisht prej kësaj, Matoshi ka thënë se nuk është dëmtuar partneriteti me kryeministrin Haradinaj dhe me partitë e koalicionit. "E kemi thënë edhe më herët, se AKR-ja e ka bërë këtë Qeveri. AKR-ja e ka shpëtuar edhe tash këtë

Qeveri", është shprehur Matoshi. Ai është i bindur se kjo Qeveri do ta çojë deri në fund mandatin qeverisës sepse, sipas tij, ky është edhe përkushtimi i AKR-së. Ndërkaq kërkesën e opozitës për zgjedhje të reja e sheh si punë që i takon opozitës

## Haradinaj kërkon përfshirjen e ShBA-së në dialogun Kosovë - Serbi

Kryeministri Ramush Haradinaj vazhdon të insistojë për një rol më të fuqishëm të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në dialogun ndërmjet Kosovës

dhe Serbisë që po zhvillohet në Bruksel me lehtësimin e Bashkimit Evropian. Ai ka thënë të enjten se në fazën finale të këtij procesi duhet të përfshihen presi-



FAQE 7

denti amerikan Donald Trump, kancelarja gjermane Angela Merkel, kryeministrja britanike Theresa May dhe presidenti francez Emmanuel Macron



## Pacolli kërkon përkrahjen e Greqisë për në Interpol dhe UNESCO

FAQE 3

Ministri i Jashtëm dhe zëvendëskryeministri i parë i Qeverisë së Kosovës, Behgjet Pacolli, ka pritur të enjten në takim homologun e vet grek, Nikos Kotzias, nga i cili ka kërkuar përkrahjen e Greqisë për në Interpol dhe UNESCO. Kotzias ka bërë me dije se vendi i tij

e mbështet planin e integritimit evropian të Kosovës në të gjitha nivelet. Ai e ka ftuar Pacollin për një vizitë në Athinë. "Të krijojmë një agjendë pozitive marrëdhënies, të përparojmë hap pas hapi, të mos mbetemi të burgosur të historisë", ka thënë ministri grek

**RENOVA**  
Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
PUTZ  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GRUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**SatStyro**  
Mushnikovë-Prizren-Kosovë  
Product of EPS and XPS  
Mob.: +377(0) 44 506 815  
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030  
e-mail: [sat\\_styro@yahoo.com](mailto:sat_styro@yahoo.com)  
[www.satstyro.com](http://www.satstyro.com)

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjobiznesi.com](http://www.kolegjobiznesi.com)  
info@kolegjobiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

# Edi Ramës i hedhin miell në Kuvend

Opozita në Shqipëri ka bllokuar foltoren e Kuvendit dhe ka kërkuar largimin e kryeministrit Edi Rama për shkak të gjuhës së tij vulgare dhe pa etikë. Seanca është ndërprerë dy herë nga kreu i Kuvendit, Gramoz Ruçi, gjë që nuk e ka penguar opozitën të godasë me miell, letra dhe shishe uji kryeministrin Rama

**TRANË, 12 PRILL** - Opozita ka bllokuar të enjten në Shqipëri seancën parlamentare dhe ka kërkuar largimin e kryeministrit Rama për shkak të gjuhës së tij vulgare dhe pa etikë. Seanca është ndërprerë dy herë nga kreu i Kuvendit Gramoz Ruçi, gjë që nuk e ka penguar opozitën të godasë me miell, letra dhe shishe uji drejt kryeministrit, ku protagonist ka qenë deputeti demokrat Flamur Noka. Rama, i cili u prek nga pluhuri i bardhë, nuk ka reaguar, por ka hequr xhakëtën dhe ka qëndruar me këmbë.

Pas këtij momenti, Ruçi ka përjashtuar nga seanca deputetët demokratë, Noka dhe Ervin Salianji. Por, opozita nuk është mjaftuar me aq, sepse deputeti tjetër demokrat, Klevis Balliu, ka goditur me letra dhe shishe me ujë në drejtim të kryeministrit. Kryeparlamentari Ruçi i ka komunikuar Balliut përjashtimin nga seanca dhe ka kërkuar mbledhjen e Byrosë për ndëshkim të deputetëve që kanë thyer rregulloren dhe kodin e etikës.

Kryetari i parlamentit ndërhyri disa herë duke i kujtuar Bashës se ishte në shkelje të rregullores së parlamentit. Ky ishte momenti i ndërprerjes së parë të seancës. Rifillimi i saj e gjeti sërish opozitën të grumbulluar rreth foltores dhe me një reagim më të ashpër, ndërsa disa prej deputetëve të saj lëshuan qese me miell drejt kryeministrit Rama. Pas miellit do të vinte radha e sendeve të tjera apo dhe shi-



sheve të ujit. Kryeministri Rama nuk reagoi dhe qëndroi pa lëvizur në vendin e tij. Në krah, ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati, nuk e shmangu dot kundërpërgjigjen, duke hedhur ujë drejt deputetëve të opozitës.

Më vonë, përmes një statusi në "Facebook", ai u shpreh i keqardhur "për reagimin instinktiv ndaj agresionit të ulët me miell, vezë e të tjera mjete rrethanore, nga grupi i pushtuesve të dhunshëm të foltores së Kuvendit, pa llogaritur lumin e të sharave vulgare", shkroi Bushati, duke i kërkuar ndjesë qetarëve që nuk arriti ta ruajë "gjakftohësinë në ato kushte krejt të papranueshme për çdo mjedis publik, e lëre

më pastaj për një parlament demokratik", u shpreh Bushati.

Më herët, duke përfutur nga ardhja e Ramës në seancë, deputeti i Partisë Demokratike, Flamur Noka, ka gjetur një mënyrë për ta simbolizuar edhe më shumë protestën e opozitës në mbrojtje të kuksianëve të arrestuar për "Rrugën e Kombit".

Deputeti i Kukësit i është afruar Ramës dhe para tij ka lënë një parullë me mbishkrimin "Liro kuksianët". Rama nuk reagon, ndërkohë një oficer i Gardës së Republikës i afrohet Nokës, i cili e këshillon të mos e heqë parullën.



## Meta takon ambasadorin Lu, diskutojnë për reforma në drejtësi

**TRANË, 12 PRILL** - Ambasadori amerikan në Tiranë, Donald Lu, të enjten ishte në selinë e Presidencës, ku qëndroi përreth një orë në një takim me kreun e shtetit, Ilir Meta. Interesimit të mediave lidhur me takimin mes presidentit Meta dhe ambasadorit Lu, drejtori i kabinetit të presidentit, Arben Cici, iu përgjigj: "Presidenti i Republikës, Ilir Meta, priti të enjten në një takim ambasadorin e ShBA-së në Shqipëri, Donald Lu, me të cilin diskutuan mbi marrëdhëniet e shkëlqyera mes dy vendeve tona dhe mbi çështjet aktuale të sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare. Në kuadër të integritit evropian të Shqipërisë, çështjes së rëndësishme të hapjes së negociatave, u nënvizua rëndësia e ecurisë dhe implementimit të reformës në drejtësi dhe u shkëmbyen mendime rreth situatës aktuale në vend. Fryma e përzemërt, miqësore dhe bashkëpunuese karakterizoi, ashtu si gjithmonë, këtë takim". Takimi erdhi një ditë pas publikimit të letrës së ish-kryeprokurorit Adriatik Llalla për Kongresin amerikan, ku akuzonte ambasadorin Lu se i kishte kërkuar pikërisht arrestimin e Metës, asokohe kryetar i Kuvendit të Shqipërisë dhe kreu i Lëvizjes Socialiste për Integritim. Më vonë, ambasadori Lu, përmes një deklarate për mediat, mohoi ta kishte kërkuar arrestimin e Metës dhe e akuzoi ish-Prokurorin e Përgjithshëm, Llalla, një gënjeshtar, "i cili rrezikon të përfundojë në burg për akuzat për korrupsion". Pikërisht për këto akuzë, Prokuroria e Durrësit ka hapur një hetim ndaj Llallës.

# KMShK-ja shënon 12-vjetorin e themelimit

**PRISHTINË, 12 PRILL** - Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMShK) ka shënuar të enjten 12-vjetorin e themelimit.

Në fjalën e tij hyrëse, Nehat Islami, drejtor ekzekutiv i KMShK-së, ka thënë se Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës mbron qytetarin nga shkrimet joetike dhe të pavërteta, si dhe gazetarët nga akuzat e pabaza që mund të vijnë. "Ajo që vlen të theksohet në veçanti është se Kodi i Mediave mbron qytetarin dhe gazetarin duke mbajtur lart prestigjin profesional. Shtimi i numrit të ankesave për dyzetë herë në krahasim me vitet e para, tregon se ai tani është më i besueshëm", ka thënë Islami.

Dinka Zivalj, shefe e sektorit për komunikim dhe zëdhënës e Zyrës së BE-së në Kosovë, ka urrejtur KMShK-në për shënimin e 12-vjetorit, duke thënë se është e rëndësishme që mediat të marrin rolin kryesor për të ndaluar gjuhën e urrejtjes, lajmet e rreme, dhe propagandën.

Ndërkaq Marina Tuneva, drejtoreshë e Këshillit të Mediave të Shkruara të Maqedonisë, e cila foli në emër të projektit



"Ndërtimi i Besimit në Media në Europën Juglindore dhe Turqi", ka theksuar se po mbështesin mekanizmat llogaridhënës të mediave, pasi ata luajnë rol kryesor në ngritjen e standardeve profesionale dhe etike, duke i bërë bashkë lexuesit, publikun dhe mediat.

Balazs Weyer, anëtar i Bordit të Aleancës së Këshillëve të Pavarur të Mediave të Evropës, duke folur për besimin e publikut në lirinë e mediave, shtoi se: "Liria e mediave nuk është vetëm formalitet. Nuk ka të bëjë vetëm me ligjet dhe rregullimin. Liria është e rrënjësuar thellësisht në besimin e publikut. Ky besim është rrjedhë për lirinë e mediave dhe cilësinë e tyre, sepse kur nuk ka besim, nuk ka rëndësi se çfarë shkruajmë dhe publikojmë". Pjesëmarrës në këtë ceremoni ishin përfaqësues të Aleancës së Këshillëve të Pavarur të Mediave të Evropës dhe Këshillëve të Mediave të rajonit, diplomatë, përfaqësues të BE-së në Kosovë, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të organizatave që merren me media, si dhe gazetarë e redaktorë të mediave.

## Hahni dhe Mogherini sjellin Raportin e Progresit më 17 prill

**TRANË, 12 PRILL** - Shefja për politikë të Jashtme e BE-së, Federica Mogherini dhe eurokomisionari për zgjerimin, Johannes Hahn, do t'i dorëzojnë Qeverisë shqiptare raportin e

progresit për zgjerimin më datë 17 prill në Tiranë. Mësohet se pas vizitës në Tiranë, dy zyrtarët e lartë të BE-së do të udhëtojnë drejt Maqedonisë, e cila është në hapat e fundit të negociatave

për emrin në Greqinë, lëvizje që do t'i hapte rrugën procesit integruar.

Komisioni Evropian do ta publikojë raportin e progresit më 17 prill, bashkë me

vlerësimet për progresin e arritur vjetor. Qeveria shqiptare pret që pikërisht atë ditë të vijë edhe propozimi për çeljen e negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Evropian.



Ministri i Punëve të Jashtme të Greqisë, Nikos Kotzias, viziton Kosovën

# Pacolli kërkon përkrahjen e Greqisë për në Interpol dhe UNESCO

Ministri i Jashtëm dhe zëvendëskryeministri i parë i Qeverisë së Kosovës, Behgjet Pacolli, ka pritur të enjten në takim homologun grek Nikos Kotzias, nga i cili ka kërkuar përkrahjen e Greqisë për në Interpol dhe UNESCO. Kotzias ka bërë me dije se vendi i tij e mbështet planin e integritimit evropian të Kosovës në të gjitha nivelet. Ai e ka ftuar Pacollin për një vizitë në Athinë. "Të krijojmë një agjendë pozitive marrëdhëniesh, të përparojmë hap pas hapi, të mos mbetemi të burgosur të historisë", ka thënë ministri grek

**EPOKA E RE**

Shqipe HETEMI

**PRISHTINË, 12 PRILL** - Në kuadër të turit të vet ballkanik, ministri i Jashtëm grek, Nikos Kotzias, ka qëndruar të enjten në Prishtinë. Në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari", Kotziasin e ka pritur zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli në një ceremoni

nga diplomatët grekë në krye të misionit diplomatik në Prishtinë, në krye të EULEX-it, ashtu dhe mbështetjen e komisionarit Avramopulos për liberalizimin e vizave për Kosovën. Ndërkaq ministri grek Nikos Kotzias e ka ftuar Pacollin ta vizitojë Athinën. "Hajdeni dhe komunikoni idetë tuaja të mrekullueshme me ndërmar-



sur të historisë", ka thënë ministri grek.

Kotzias e ka ftuar Kosovën në takimet e organizatës EUROMED, të shtatë vendeve të Mesdheut për t'i shfaqur pozicionet e veta dhe për ta rritur bashkëpunimin evropian. "Kosova i takon rajonit dhe ne do ta ndihmojmë Kosovën sepse ndihmojmë veten", ka deklaruar ministri Kotzias. Ai ka shtuar se ka respekt për përpjekjet e Kosovës për ndërtimin e një realiteti të ri në rajon dhe se e mbështet pjesëmarrjen e saj në Samitin e Sofjes.

Më tej, kryediplomati grek Kotzias ka shprehur gatishmërinë e vendit të tij për të ndihmuar në bisedimet midis Serbisë dhe Kosovës, për restaurime objektesh të trashëgimisë kulturore.



shumë të ngrohtë dhe miqësore. Pacolli ka thënë se ka marrë mbështetjen e Greqisë për Kosovën, në Samitin e Sofjes dhe në forume të tjera ndërkombëtare. Ai ka theksuar se Kotzias ishte shumë i qartë në mbështetjen e Greqisë për Kosovën. "Ne presim që Greqia të na mbështesë në integrimin tonë ndërkombëtar ashtu si ka bërë edhe më parë, në UNESCO dhe Interpol. Ne duam praninë e investitorëve dhe mallrave greke në Kosovë", ka thënë Pacolli, kërkesë kjo që u pranua prej homologut të tij grek, Nikos Kotzias.

Ministri Pacolli ka bërë thirrje për heqjen e pengesave në lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe bizneseve të Kosovës në Greqi. Ai ka vlerësuar punën e bërë

rësit tanë në një forum biznesi midis dy vendeve. Të krijojmë një agjendë pozitive marrëdhëniesh, të përparojmë hap pas hapi, të mos mbetemi të burgo-



## Thaçi e Kotzias flasin për e hapjen e zyrës së Kosovës në Athinë

Ministrin e Punëve të Jashtme të Greqisë, Nikolaos Kotzias, e ka pritur në takim edhe presidenti Hashim Thaçi. Me këtë rast, Thaçi ka thënë se e çmon pozicionin pozitiv dhe parimor të Greqisë për perspektivën evropiane të Kosovës. "Jemi mirënjohës për përkrahjen e Greqisë për anëtarësim në organizata ndërkombëtare dhe kërkojmë që kjo përkrahje të vazhdojë edhe për anëtarësimin tonë në Interpol, UNESCO, NATO, Bashkim Evropian dhe në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Është shumë me rëndësi që Greqia ta ruajë qëndrimin konstruktiv", ka deklaruar Thaçi. Kreu i shtetit me ministrin Kotzias kanë folur edhe për rëndësinë e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në Bruksel, i cili forcon paqen në tërë rajonin tonë. Presidenti Thaçi dhe ministri i

Jashtëm i Greqisë, Nikolaos Kotzias, kanë diskutuar edhe për thellimin e bashkëpunimit ekonomik. "Kosova ka krijuar një ambient biznesor mjaft atraktiv dhe janë të mirëseardhur investitorët grekë", është shprehur presidenti Thaçi. Ndërsa kryediplomati grek ka thënë se normalizimi i marrëdhëniesh mes shteteve në Ballkanin Perëndimor, por edhe në vetë Bashkimin Evropian, është shumë i rëndësishëm për të gjitha shtetet. "Greqia e mbështet planin e integritimit evropian në të gjitha nivelet", është shprehur Kotzias. Gjatë takimit të presidentit Thaçi me ministrin e Jashtëm të Greqisë është diskutuar edhe për procesin dhe modalitetin e hapjes së zyrës së Kosovës në Athinë, e cila do të ndihmonte në forcimin e marrëdhëniesh bilaterale në mes të Kosovës dhe Greqisë.

## Beqë Cufaj, ambasador i Kosovës në Gjermani

**PRISHTINË, 12 PRILL** - Presidenca e Kosovës ka emëruar Beqë Cufajn ambasador rezident në Republikën

Federale të Gjermanisë. Me këtë dekret, Ministria e Punëve të Jashtme ngarkohet t'i ndërmanë të

gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e vendimit të presidentit Hashim Thaçi. Beqë Cufaj është

shkrimtar dhe gazetar. Aika studiuar gjuhën dhe letërsinë në Prishtinë dhe jeton në Shtutgart.



Flet për "Epokën e re", Fatmir Matoshi

# AKR-ja e bëri këtë Qeveri dhe e sh

Nënkryetari i Aleancës Kosova e Re (AKR), Fatmir Matoshi, ka thënë se kjo parti nuk ka qenë e kënaqur me kërkesën e kryeministrit Ramush Haradinaj për ta liruar Flamur Sefaj postin e ministrit të Punëve të Brendshme. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kjo kërkesë ishte e padrejtë. Pavarësisht prej kësaj, Matoshi ka thënë se nuk është dëmtuar partneriteti me kryeministrin Haradinaj dhe partnerët e koalicionit. "E kemi thënë edhe më herët, se AKR-ja e ka bërë këtë Qeveri. AKR-ja e ka shpëtuar edhe tash këtë Qeveri", është shprehur Matoshi. Ai është i bindur se kjo Qeveri do ta çojë deri në fund mandatin qeverisës sepse, sipas tij, ky është edhe përkushtimi i AKR-së. Ndërkaq kërkesën e opozitës për zgjedhje të reja e sheh si punë që i takon opozitës



**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 12 PRILL** - Nënkryetari i Aleancës Kosova e Re (AKR), Fatmir Matoshi, ka bërë me dije se vullneti i këtij subjekti politik është që Kosova të ketë një Qeveri me shumicë shqiptare. Ai ka thënë se presidenti i këtij subjekti politik, Behgjet Pacolli, çdo herë ka qenë ihtar i kësaj ideje. Megjithatë, në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se Qeveria aktuale e ka shumicën e nevojshme në Kuvendin e Kosovës dhe, si e tillë, do ta vazhdojë mandatin e saj. "Ajo që dihet është qëndrimi i presidentit Pacolli, i cili ka thënë se është i interesuar për një Qeveri me shumicë shqiptare. Pra, vullneti i AKR-së është që Kosova të ketë një Qeveri me shumicë shqiptare", ka thënë Matoshi. Ai ka treguar se formimi i një Qeverie të tillë nuk varet vetëm prej AKR-së. "Dihet se kjo nuk varet prej AKR-së. Kjo varet prej shumë faktorëve; prej partive që janë në pushtet, pastaj edhe prej partive që janë në opozitë", është shprehur ai. Matoshi beson se Lista Serbe ende është pjesë e koalicionit qeverisës. Sipas tij, veprimet e këtij subjekti politik janë vetëm

lojëra politike. "Kjo Qeveri do të jetë gjatë në detyrë, sepse mendojmë se Qeveria e ka shumicën e nevojshme. Me siguri se e kemi parë që ministrat e Listës Serbe dalin në punë, kurse lojërat politike nuk mund t'i komentoj", është shprehur Matoshi. Nënkryetari i AKR-së ka mohuar mundësinë që shkarkimi i ministrit të Punëve të Brendshme ta ketë dëmtuar partneritetin mes kësaj partie dhe kryeministrit Haradinaj. "Ne nuk kemi qenë të kënaqur me kërkesën e kryeministrit që z. Sefaj ta lironte detyrën. Kjo kërkesë ka qenë e padrejtë, mirëpo kjo nuk e ka dëmtuar partneritetin tonë. E kemi thënë edhe më herët, se AKR-ja e ka bërë këtë Qeveri. AKR-ja e ka shpëtuar edhe tash këtë Qeveri. Natyrisht se AKR-ja do të vazhdojë të jetë e

përkushtuar që kjo Qeveri ta çojë deri në fund mandatin", ka thënë Matoshi.

Ai ka folur edhe për emërimin e ministrit të ri në krye të MPB-së. Matoshi ka bërë me dije se emërimi i ministrit të ri pritet të ndodhë shumë shpejt.

**"Epoka e re":** Z. Matoshi, AKR-ja ka paralajmëruar se këtë javë do të dalë me emrin e ministrit të Punëve të Brendshme. Kur do të ndodhë kjo?

**Matoshi:** Tani nuk mund të them saktë se kur, sepse ende nuk kemi një emër për ministër të Punëve të Brendshme. Kjo çështje është në dorë të presidentit të partisë. Besoj se shumë shpejt ai do ta propozojë emrin për ministër të Punëve të Brendshme në konsultim edhe me strukturat e partisë.

**"Epoka e re":** Ende nuk keni gjetur ndonjë emër?

**Matoshi:** E di se brenda strukturave të AKR-së çdokush ka të drejtë ta propozojë një emër, qoftë degët apo Kryesia e AKR-së. Pastaj presidenti Pacolli i shqyrton ato propozime të strukturës dhe më pas vendos.

**"Epoka e re":** Emri juaj është lakuar për këtë post?

**Matoshi:** Nuk do të jem unë ministër i Punëve të Brendshme. E falënderoj strukturën e AKR-së që më ka mbështetur.

**"Epoka e re":** Po emri i ekspertit të sigurisë, Florian Qehaja?

**Matoshi:** Ai tashmë e ka demantuar këtë lajm, duke thënë se ka qenë vetëm spekulim i mediave.

**"Epoka e re":** Ministri i ardhsh-

men i Punëve të Brendshme do të jetë brenda strukturave të AKR-së apo jashtë strukturës?

**Matoshi:** Unë kisha dashur që emri i këtij ministri të jetë dikush nga strukturat e AKR-së, në të kundërtën nuk do të kishte ndonjë kuptim.

**"Epoka e re":** Shkarkimi i ministrit Sefaj e ka dëmtuar partneritetin e AKR-së me kryeministrin?

**Matoshi:** Ne nuk kemi qenë të kënaqur me kërkesën e kryeministrit që z. Sefaj ta lironte detyrën. Ajo kërkesë ka qenë e padrejtë, mirëpo kjo nuk e ka dëmtuar partneritetin tonë. E kemi thënë edhe më herët, se AKR-ja e ka bërë këtë Qeveri. AKR-ja e ka shpëtuar edhe tash këtë Qeveri. Natyrisht se AKR-ja do të vazhdojë të jetë e përkushtuar që kjo Qeveri ta çojë

# pëtoi pa rënë

**Matoshi:** Kjo i tejkalon kompetencat e mia. Ajo që dihet është se qëndrimi i presidentit Pacolli ka qenë për një Qeveri me shumicë shqiptare. Pra, vullneti i AKR-së është që Kosova të ketë një Qeveri me shumicë shqiptare.

**"Epoka e re":** Kjo do të thotë se edhe AKR-së do t'i zvogëlohet pjesa në pushtet?

**Matoshi:** Edhe para se të bëhet kjo Qeveri, AKR-ja ka deklaruar se është e gatshme për të hyrë në koalicion edhe pa ndonjë ministri, vetëm që të kemi një Qeveri me shumicë shqiptare. Për AKR-në nuk kanë qenë ndonjëherë problem postet qeveritare.

**"Epoka e re":** Sa janë gjasat të ndodhë një Qeveri me shumicë shqiptare?

**Matoshi:** Dihet se kjo nuk varet prej AKR-së. Kjo varet prej shumë faktorëve. Prej partive që janë në pushtet, pastaj edhe prej partive që janë në opozitë.

**"Epoka e re":** Deri kur do të vazhdojë kjo Qeveri, e cila tani nuk e ka shumicën në Kuvendin e Kosovës?

**Matoshi:** Kjo Qeveri do të jetë gjatë në detyrë. Ne mendojmë se Qeveria e ka shumicën e nevojshme. Me siguri se e kemi parë që ministrat e Listës Serbe dalin në punët e tyre, kurse lojërën politike nuk mund t'i komentoj. Ndërsa qeveritë dihet se si rrezohen, me mocion mosbesimi.

**"Epoka e re":** Pra, mendoni se Lista Serbe ende është në koalicion qeverisës dhe se po bën vetëm lojërë politike?

**Matoshi:** Sigurisht se po.

**"Epoka e re":** Dy subjektet kryesore opozitare, LDK-ja dhe Lëvizja Vetëvendosja, kanë paralajmëruar mocion mosbesimi ndaj Qeverisë. I frikësoheni kësaj iniciative?

**Matoshi:** Nuk i frikësohemi. Është e drejtë e partive opozitare për ta kundërshtuar Qeverinë dhe për të iniciuar mocione mosbesimi. Ky është roli i partive opozitare.

**"Epoka e re":** Besoni se mund të realizohet një mocion i tillë?

**Matoshi:** Edhe nëse realizohet nuk është fundi i botës. Në demokraci rregullat janë të përcaktuara qartë. Nëse kalon mocioni i mosbesimit të opozitës atëherë duhet të shkojmë në zgjedhje të reja. Nuk besoj se ka diçka të keqe këtu.

**"Epoka e re":** Zgjedhjen e reja mendoni se do të jenë zgjedhje në këtë kohë?

**Matoshi:** Mendoj se nuk janë zgjedhje, por ne nuk mund t'i ndryshojmë rregullat. Ajo që mund të them, është se AKR-ja çdoherë është e gatshme për zgjedhje të reja, kurdo që ato të mbahen.

mandatin deri në fund.

**"Epoka e re":** Nëse kërkesa e kryeministrit për shkarkimin e Sefajit ka qenë e padrejtë, atëherë pse e keni pranuar atë?

**Matoshi:** Besoj se ne edhe me këtë rast e kemi shpëtuar Qeverinë.

**"Epoka e re":** Kjo do të thotë se Qeveria ka mundur të bjerë me rastin e shkarkimit të ministrit Sefaj?

**Matoshi:** I bie se AKR-ja e ka shpëtuar Qeverinë edhe këtë herë.

**"Epoka e re":** Pas daljes në opozitë të Listës Serbe është folur shumë për mundësinë e zgjerimit të koalicioni qeverisës. Sa ka gjasa të ndodhë kjo?

# Kuvajti konfirmon mbështetjen për Kosovën

**EPOKA  
ERE**

Faton DERMAKU

**PRISHTINË, 12 PRILL** - Kryetari i Kosovës, Kadri Veseli, ka pritur të enjten në takim Grupin Parlamentar të Miqësisë Kuvajt - Kosovë, të kryesuar nga Waleed Altabtabae, deputet i Kuvendit të Kuvajtit dhe kryetar i Grupit të Miqësisë. Kryeparlamentari Veseli i njoftoi mysafirët nga Kuvajti me zhvillimet aktuale në Kosovë dhe për përparimet e saj si në rrafshin ndërkombëtar, po ashtu edhe në aspektin e brendshëm. Veseli ka falënderuar parlamentarët kuvajtianë për

mbështetjen e vazhdueshme të shtetit të tyre për Kosovën në institucionet kryesore ndërkombëtare si dhe për lobimin tek shtetet islamike për njohjen e pavarësisë së Kosovës. Kreu i Kuvendit ka theksuar se Republika e Kosovës dëshiron t'i thellojë marrëdhëniet me Kuvajtin në të gjitha fushat, në dobi të interesave e të bashkëpunimit reciprok dhe të miqësisë midis dy vendeve dhe popujve. Ndërkaq deputetët nga Kuvajti shprehën kënaqësinë që gjenden për vizitë në Kosovë dhe për të arriturat e saj në shumë fusha. Duke shprehur dëshirën dhe gatishmërinë për

thelimin e marrëdhënieve e të bashkëpunimit midis dy vendeve, ata theksuan se kjo vizitë është një mundësi e mirë për t'u njohur me zhvillimet në të dyja vendet dhe për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet parlamenteve respektive. Ata konfirmuan mbështetjen e Kuvajtit për Kosovën edhe në të ardhmen.

Kreu i delegacionit të Kuvajtit, Waleed Altabtabae, ka ftuar kryeparlamentarin Veseli për vizitë zyrtare në Kuvajt, për ta forcuar bashkëpunimin midis dy vendeve edhe në fusha të tjera, me theks të veçantë në ekonomi.



## Takohen Grupi Parlamentar i Miqësisë së Kosovës dhe ai i Kuvajtit

Grupi parlamentar i Miqësisë Kuvajt - Kosovë, në kuadër të vizitës në Kosovë, është pritur të enjten në një takim të veçantë nga grupi homolog i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Zafir Berisha, në emër të grupit të miqësisë të Kuvendit të Kosovës, u ka shprehur mirëseardhje mysafirëve nga Kuvajti. Ai i njoftoi miqtë kuvajtianë me punën, rolin dhe përbërjen e Kuvendit të

Republikës së Kosovës, si institucioni më i lartë përfaqësues dhe ligjvënës i vendit.

Deputeti Berisha po ashtu foli për arritjet e shtetit të Kosovës në shumë segmente, ndërsa ka shtuar se ende ka nevojë për mbështetjen e miqve të tij.

Kryetari i Grupit të Miqësisë me Kuvajtin ka theksuar se Kuvendi i Kosovës dhe Asambleja Kombëtare e

Kuvajtit tashmë kanë krijuar një traditë të mirë të shkëmbimit të vizitave të delegacioneve të larta parlamentare dhe shtroi nevojën që ky bashkëpunim të shtohet edhe më tej në të ardhmen. Deputetja Flora Brovina para miqve ka shprehur falënderimin për njohjen e pavarësisë së Kosovës nga Kuvajti, ndërsa ka theksuar nevojën për forcimin e marrëdhënieve të dy vendeve.

## "Demokracia Studentore" kërkon dorëheqjen e rektorit

PRISHTINË, 12 PRILL - Organizata "Demokracia Studentore" ka zhvilluar të enjten një aksion simbolik në shenjë pakënaqësie me gjendjen në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina". Kjo organizatë ka shprehur pakënaqësinë për keqmenax-

himin e Universitetit të Prishtinës, për aferat e keqpërdorimit të detyrës zyrtare, për shpëlarjen e parave në UP përmes OJQ-ve, në fund ka kërkuar dorëheqjen e rektorit Marjan Dema.

Kryetari i Organizatës "Demokracia Studentore",

Mexhid Ramusa, ka thënë se janë mbledhur para Rektoratit për t'i kundërshtuar masat që po bëhen në këtë institucion. Ai ka shtuar se rektori i UP-së ka shpërlarë para dhe askush nuk e ka ngrehur zërin për këtë çështje deri më tani.



# MASHT-i dhe WUS Austria nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi



**EPOKA E RE**

**Arbisa SHEFKIU**

PRISHTINË, 12 PRILL - Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) dhe Shërbimi Botëror i Universitetit të Austrisë (WUS Austria) kanë nënshkruar të enjten marrëveshje bashkëpunimi për administrimin e grantit për bashkëfinancimin e

projektit "HERAS - Arsimit i Lartë, Hulimtimit dhe Shkencat e Aplikuara".

Ministri i Arsimit, Shyqiri Bytyqi dhe Veronika Nitsche, përfaqësuese e WUS Austria, theksuan se qëllimi i kësaj marrëveshje ishte thellimi i mëtejshmë bashkëpunimit me shtetin e Austrisë, i cili është një nga partnerët kryesor për zhvillimin e

arsimit të lartë.

Ministri Bytyqi e ka vlerësuar të rëndësishëm zyrtarizimin e marrëveshjes me WUS Austria, ndërsa ka falënderuar përfaqësuesen e Qeverisë së Austrisë, e cila, përmes kësaj marrëveshje dhe marrëveshjeve të mëhershme, ka përkrahur studentët tanë në fushën e hulumtimit shkencor. "Konsideroj se me mar-

rëveshjen e nënshkruar sot dhe me gatishmërinë e të dyja palëve për një bashkëpunim të sigurt, ne po hapim mundësi të reja për të rinjtë tanë që, përveç studimeve, të kenë mundësi ta zhvillojnë edhe pjesën e hulumtimit, pjesën shkencore", është shprehur ministri Bytyqi. Po ashtu, ministri Bytyqi ka falënderuar shtetin e Austrisë

për ndihmën që i ka bërë Kosovës në anëtarësimin e saj COST, e cila u hapë rrugë studentëve për të përfituar nga projekte të ndryshme shkencore.

Veronika Nitsche, përfaqësuese e WUS Austria, ka falënderuar Ministrinë e Arsimit dhe ministrin Bytyqi për bashkëpunimin që kanë zhvilluar me projektin HERAS.

## Zëvendësministri Dedaj kërkon heqjen urgjente të vizave për Kosovën

PRISHTINË, 12 PRILL (ER) - Zëvendësministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, Gjergj Dedaj, po merr pjesë në një konferencë dyditore për Ballkanin Perëndimor të organizuar në Parlamentin Evropian në Bruksel nga Aleanca Liberale Demokratike e Evropës. Në këtë konferencë ishin të pranishëm edhe komisionari për Fqinjësi dhe Zgjerim të BE-së, Johannes Hahn, presidenti i ALDE-së, Hans Van Baalen dhe liderë dhe përfaqësues të partive liberale të

Ballkanit Perëndimor si dhe të shoqërisë civile.

Zëvendësministri Dedaj në këtë konferencë ka ngritur para pjesëmarrësve çështjen e heqjes urgjente të vizave për qytetarët dhe perspektivën euroatlantike të Kosovës dhe vendeve të Ballkanit. "Bashkimi Evropian duhet të jetë i shqetësuar ndaj tendencave rusoturke për dominim në këtë pjesë të Ballkanit e cila gjeografikisht, politikisht dhe në pikëpamje të kulturës dhe civilizimit është pjesë e

Bashkimit Evropian", ka thënë zëvendësministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, Gjergj Dedaj. Ai ka ritheksuar se Evropa nuk duhet të ndërtojë "mure të reja të Berlinit", por të jetë e hapur dhe e gatshme t'i pranojë në familjen e vet të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. "Nëse një gjë e tillë nuk vazhdon, do të krijohet hapësirë influence dhe ndikimi për botën tjetër, e cila nuk i kontribuon paqes, stabilitetit as sigurisë në Ballkan dhe Evropë", ka thënë Dedaj.



Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka marrë pjesë në diskutimin "Fol hapur" të organizuar nga Lëvizja FOL

## Haradinaj kërkon përfshirjen e ShBA-së në dialogun Kosovë - Serbi

Kryeministri Ramush Haradinaj vazhdon të insistojë për një rol më të fuqishëm të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë që po zhvillohet në Bruksel me lehtësimin e Bashkimit Evropian. Ai ka thënë të enjten se në fazën finale të këtij procesi duhet të përfshihen presidenti amerikan Donald Trump, kancelarja gjermane Angela Merkel, kryeministrja britanike Theresa May dhe presidenti francez Emmanuel Macron

**EPOKA E RE**

Shqipe HETEMI

**PRISHTINË, 12 PRILL** - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë të enjten se Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) duhet të kenë rol më të fuqishëm në procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në diskutimin "Fol hapur" të organizuar nga Lëvizja FOL, Haradinaj ka vlerësuar se epilogu i këtij dialogu duhet të jetë njohja reciproke ndërmjet dy vendeve. Kryeministri është shprehur kundër vazhdimin të dialogut me këtë format. "Ju kam thënë se duhet të kalojmë në fazën finale të bisedimeve që nënkupton njohjen reciproke mes dy shteteve. Këtë ia kam thënë edhe Federica Mogherin. Nëse ndodh kështu, është mirë për Kosovën. Ndryshe status quo-ja është e dëmshme për vendin dhe rrezikon ta kthejë prapa. Unë asnjëherë s'kam qenë krejt i bindur se kur i harxhojmë marrëveshjet dhe të kalojmë në një fazë finale për shkak se faza finale është vullneti politik i vendimmarrësve të mëdhenj. Për fazën finale edhe presidenti Donald Trump duhet të ketë pak kohë të merret me

Kosovën, edhe kancelarja gjermane Angela Merkel, kryeministrja e Britanisë së Madhe, Theresa May dhe presidenti francez Emmanuel Macron", ka deklaruar Haradinaj. Ai ka thënë se pajtohet që në krye të dialogut të jetë presidenti i vendit, Hashim Thaçi pasi, sipas tij, kryeministri i vendit edhe ashtu është shumë i zënë me punë, kurse presidenti ka më shumë kohë. "Këtu secili ka rol, Qeveria ka shumë rol në dialog. Por, është shumë mirë që presidenti i vendit ta udhëheqë agjendën. Presidenti i vendit nuk ka shumë punë, ai kur shkon në zyrë në mëngjes duhet të kërkojë se çfarë të punojë, kurse kryetari i Qeverisë nga ngarkesa shikon çka mund të shtyhet, cilat tema mund të presin. Edhe është shumë mirë që presidenti ka qenë i kyçur si kryetar i Qeverisë", është shprehur Haradinaj. Kryeministri Haradinaj është shprehur i bindur se qytetarët e Kosovës së shpejti do të udhëtojnë pa viza. Sipas tij, ky konfirmim do të vijë së shpejti nga BE-ja. Kurse sa i përket luftimit të krimin dhe korrupsionit, Haradinaj ka thënë se për këtë çështje institucionet janë në angazhime të vazh-



dueshme, të cilat, sipas tij, do të vazhdojnë edhe pas liberalizimit të vizave. "Çështja e luftës kundër korrupsionit është çështje e këtij vendi, e kësaj shoqërie dhe në çdo etapë të avancimit tonë drejt BE-së. Tema e korrupsionit çdoherë do të jetë më e nxehtë, pra do të jetë proces që kurrë nuk ndalet", ka deklaruar Haradinaj.

## Asociacioni do të verifikohet nga Gjykata Kushtetuese

Kryeministri Haradinaj, në diskutimin "Fol hapur" të organizuar nga Lëvizja FOL, ka folur edhe për statutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Ai ka thënë se ky asociacion do të verifikohet nga Gjykata Kushtetuese. "Ky është një proces serioz që është nisur duke u bazuar në obligimet që ka Kosova. Statuti i Asociacionit duhet të verifikohet në Gjykatën Kushtetuese", ka theksuar ai. Në këtë debat kryeministri Haradinaj ka folur edhe për formimin e ushtrisë së Kosovës. Ai ka thënë se kjo çështje nuk është pjesë e marrëveshjes me Listën Serbe. "Kosova e ka një opion, që është ligji. Një ndryshim në bazë të ligjit. Ne duhet ta konsumojmë arritjen që të gjitha palët të siguro-

hen që Kosova është e gatshme që përmes ndryshimeve kushtetuese të arrihet dalja për këtë temë", ka deklaruar ai. Ndërkaq duke folur për funksionimin e Qeverisë, Haradinaj ka theksuar se formimi i kësaj Qeverie nuk ka qenë proces i lehtë. Sipas tij, Qeveria është duke i zgjidhur një nga një problemet kryesore të Kosovës. "Nga marrja e përgjegjësive si qeverisje, kemi qenë të interesuar për agjendat kyçe: rendi dhe ligji, ekonomia, shëndetësia, arsimit dhe temat e tjera me radhë", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke shtuar se shqetësim i vazhdueshëm ka qenë edhe pozita rajonale dhe ndërkombëtare e shtetit të Kosovës.

## Ngrihet aktakuzë për korrupsion ndaj Pal Lekajt



**PRISHTINË, 12 PRILL (ER)** - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) ka ngritur aktakuzë ndaj ish-kryetarit të Komunës së Gjakovës, Pal Lekaj, i cili aktualisht është ministër i Infrastrukturës në Qeverinë e Kosovës. Lekaj akuzohet për dy vepra penale të përvetësimit në detyrë dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare. Lajmin për ngritjen e aktakuzës e ka konfirmuar për "Betimi për Drejtësi" prokurori special Faik Halili. Prokurori Halili ka pohuar se aktakuza ndaj Lekajt tashmë është dorëzuar në Gjykatën Themelore në Gjakovë. Pas ngrit-

jes së aktakuzës për korrupsion ka reaguar ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, duke thënë se në asnjë rast dhe rrethanë nuk ka vepruar në kundërshtim me ligjin. Ai ka bërë me dije se do të vazhdojë të jetë në krye të detyrës si ministër për t'i përmbushur obligimet ndaj qytetarëve dhe vendit. "Po lexoj në media që organet e drejtësisë paskan ngritur një aktakuzë për një çështje të para 10 vjetëve. Krejt çfarë mund të them tani për tani është se në asnjë rast e rrethanë nuk kam vepruar ndryshe, përveçse në harmoni me ligjin dhe në ndihmë për qytetarët e shumtë që kanë përfituar nga

subvencionet të cilat i ka shpërndarë komuna e Gjakovës. Ashtu siç kam qenë do të vazhdoj të jem në krye të detyrës, për t'i përmbushur obligimet tona ndaj qytetarëve dhe vendit tonë. Cilido që do të jetë epilogu i organeve të drejtësisë jam i gatshëm ta respektoj. Por nuk do të ndalemi në punën tonë, pa marrë parasysh tendencën e presionit", ka reaguar përmes një deklarate ministri Lekaj. Pal Lekaj për dy mandate ka qenë kryetar i Komunës së Gjakovës nga viti 2007 e deri në vitin 2013 kur kishte humbur garën nga Mimoza Kusari-Lila.

# IPKO-ja nënshkruan memorandum mirëkuptimi për 'zgjidhje të mençura' në bujqësi



"IPKO Telecommunications" ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me "Tetra Tech", ARD, kontraktues i USAID-it në Kosovë. Ideja e këtij projekti është që të informohen fermerët rreth kushteve agrologjike në vend dhe të pajisen me informata të nevojshme rreth sëmundjeve të bimëve

**EPOKA  
ERE****A. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 12 PRILL** - "IPKO Telecommunications" të enjten ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me "Tetra Tech", ARD, kontraktues i USAID-it në Kosovë. IPKO-ja përmes këtij memorandum do të bashkëpunojë me kontraktuesin

e USAID-it në projektin inovativ "IPKO - Parashikimi Agrologjik" në nivel ekspertësh. "Ideja e këtij projekti është të informohen fermerët kosovarë rreth kushteve agrologjike në vend, po ashtu të pajisen me informata të nevojshme rreth sëmundjeve të bimëve dhe informata të tjera specifike për lokacione të ndryshme në Kosovë. Projekti

për momentin është në fazë pilotuese. Tashmë janë të instaluar 16 stacione agrare, të cilat janë duke gjeneruar të dhëna agrologjike për fermerët", është thënë në njoftimin e IPKO-s.

Sipas këtij njoftimi, projekti do të lansohet fillimisht duke komunikuar mesazhe përmes SMS-ve për fermerët e regjistru-

ar. "IPKO-ja synon që deri në fund të projektit të instalojë deri në 100 stacione agrare, në shtatë regjione, duke mbuluar të gjithë territorin e Kosovës. Këto stacione do t'ua ofrojnë fermerëve informatat e nevojshme, përfshirë edhe matjen e kushteve të tokës dhe ajrit dhe përmes aplikacioneve specifike duke nxjerrë informacione të

nevojshme rreth parashikimit agrologjik. IPKO-ja do të investojë në industrinë bujqësore duke instaluar stacione inovative - të mençura në vende të ndryshme në Kosovë, përderisa kontraktuesi i USAID-it do të asistojë në interpretimin e të dhënave për fermerët kosovarë", është theksuar në njoftimin e IPKO-s.

## OAK-u kërkon nga MPMS-ja rritje të komunikimit me bizneset



**PRISHTINË, 12 PRILL (ER)** - Delegacioni i Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK), i kryesuar nga kryetari i bordit, Skënder Krasniqi, e në përbërje nga anëtari i bordit Hasan Gigollaj, koordinatorja Donika Gashi, zyrtarja Qëndresa Ibrahim dhe biznesmeni Mensur Bytyqi, u pritën në takim nga ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skënder Reçica. Krasniqi ka theksuar rëndësinë e koordinimit më

të mirë në mes të MPMS-së dhe përfaqësuesve të bizneseve në mënyrë që së bashku të kontribuojnë për rritjen e punësimit dhe zvogëlimin e rasteve me asistencë sociale. Problemi me ligjet, ishte një nga shqetësimet e radhës që u ngritën në këtë takim, duke theksuar më tutje se Qeveria duhet të krijojë një mekanizëm efekti dhe kundërefekti nga një ligj i caktuar, në mënyrë që ai të

mos e dëmtojë zhvillimin. Ministri MPMS-së, Skënder Reçica, ka falënderuar delegacionin e Odës së Afarizmit të Kosovës për adresimin e këtyre çështjeve dhe ka theksuar se problemet me ligje ekzistojnë dhe janë duke punuar në këtë drejtim. Në fund, të dyja palët u pajtuan për nevojën e rritjes së bashkëpunimit në mënyrë që së bashku të tejkalohen sfidat me të cilat ballafaqohen bizneset.



# Haradinaj: 'Trepça' duhet të kthehet në funksion të zhvillimit ekonomik

PRISHTINË, 12 PRILL (ER) - "Qeveria e Kosovës është e interesuar që 'Trepçën' ta ngrëjë në këmbët e veta, ngaqë 'Trepça' ka rëndësi të madhe për Kosovën", kështu ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj në takim me anëtarët e Bordit Mbikëqyrës të "Trepçës". Në këtë takim, në të cilin ishin të pranishëm edhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Ljeka dhe ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, u bisedua për punët që e presin bordin e ri për hartimin e statutit të "Trepçës",

regjistrimin e saj si shoqëri aksionare si dhe për zgjedhjen e bordit menaxhues, për të cilat kryeministri Haradinaj ka thënë se duhet të përfundojnë shumë shpejt. Haradinaj i ka inkurajuar anëtarët e ri të Bordit Mbikëqyrës që të punojnë si ekip për ta rikthyer "Trepçën" në funksion të zhvillimit ekonomik dhe për t'ia rikthyer asaj namën e dikurshëm. Ai ka thënë se i kupton problemet të cilat e presin bordin e ri të "Trepçës", por ka kërkuar angazhim nga të gjithë për zgjidhjen dhe tejkalimin e tyre.



# 'Chelsea Point' sjell stilin anglez të jetesës në Prishtinë



"Chelsea Point" po vjen me projektin e shumëpritur të shtëpive të stilit anglez në dalje të qytetit të Prishtinës, në Bërnice. Në arkitekturë parashihen shtëpitë me oborr tradicional, gjithashtu vilat dhe apartamentet e stilit "Regency". Çmimet fillestare janë nga 85 000 për apartament dhe 160 000 për shtëpi

EPOKA  
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 12 PRILL - Drejtori ekzekutiv i "Chelsea Point - Bërnica Park", Alan Fox, ka thënë se është i emocionuar dhe i kënaqur jo vetëm për vazhdimin

e punimeve në "Chelsea Point - Bërnica Park", por për gjithë regjionin e Bërnices, i cili do të përfitojë nga zhvillimi urban që do të ndodhë në këtë pjesë të kryeqytetit.

Duke folur për rinisjen e projektit të "Chelsea Point - Bërnica Park",

Fox ka thënë pas katër vjetëve të gjata prite janë finalizuar rruga dhe trotualet në këtë zonë të bukur. "Ka qenë e vështirë t'i tërheqësh familjet të cilat mendojnë të jetojnë këtu për shkak të infrastrukturës, e cila ka penguar shumë në këtë drejtim.

Sidoqoftë, tani kemi vullnetin dhe besimin që projekti të vazhdojë pa e pasur pengesë infrastrukturën. Pritja ia ka vlejtur. Kam shumë besim që familje të ndryshme do ta mirëpresin një jetë luksoze në fshat, që është larg nga qendra e Prishtinës vetëm 7 minuta", ka thënë Fox. "Bërnica Park" nga "Chelsea Point" është një krijim i shtëpive magjepsëse të llojit "Regency", të ndërtruara në stilin e arkitektit John Nash, i cili u bë i famshëm për arkitekturën me shtëpitë

"Regency" në shekullin 18 në Londër.

Në arkitekturë parashihen shtëpitë me oborr tradicional, gjithashtu vilat dhe apartamentet e stilit "Regency". Çmimet për fillim janë nga 85 000 për apartament dhe 160 000 për shtëpi. Katër lloje të shtëpive do të jenë në dispozicion që do t'i përbushin nevojat e secilës familje që kërkon një jetë të qetë dhe me standardet më të mira në Prishtinë, përkatësisht natyrën e bukur të Bërnices.

## OSBE-ja inkurajon të rinjtë rom, ashkali dhe egjiptas të bëhen pjesë e policisë

**VUSHTRRI, 12 PRILL (ER)** - Në Komunën e Vushtrrisë është mbajtur të enjten punëtorja treditore orientuese për 60 të rinj rom, ashkali dhe egjiptas, e organizuar nga misioni i OSBE-së, Akademia e Kosovës për Siguri Publike dhe Policia e Kosovës që ka pasur për qëllim njoftimin e tyre me punën e policisë dhe përfitimet e të qenit pjesë e policisë. Punëtorja i paraprin shpalljes së konkursit për oficerë të rinj që pritet të hapet muajt e ardhshëm dhe ka pasur për synim inkurajimin e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve t'i bashkohen policisë. Pjesëmarrësit (18-30 vjeç) mësuuan për kriteret e përzgjedhjes për t'u bërë oficer policie; për testet që duhet t'u nënshtrohen si testi me shkrim, fizik e psikologjik; dhe morën pjesë në

intervista të simuluar për punë. "Pavarësisht prej mekanizmave të ndryshëm për promovim të mundësive të barabarta në legjislacionin e policisë, përfshirja e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve mbetet sfidë", ka thënë Shpresa Muharremi nga misioni i OSBE-së. Ajo ka thënë se duan të shohin më shumë pjesëtarë të komuniteteve në uniforma të policisë. "Kjo do ta bënte policinë një forcë më diverse dhe do ta rriste besimin e komunitetit në polici", është shprehur Muharremi. Gjatë punëtorisë, pjesëmarrësit u njohën edhe me ligjin për policinë, trajnimin dhe kurikulën bazë, policimin në komunitet, parimet kryesore të policimit demokratik dhe rregulloret e brendshme administrative.



## Biznesmenë nga Gjermania e Zvicra shprehin interesim për investime në Mitrovicë



**MITROVICË, 12 PRILL (ER)** - Përfaqësues të lartë nga kompania "RPP-Germany", Safet Sadiku dhe Avni Nasufoski janë pritur nga kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, me të cilët ka biseduar lidhur me mundësitë e bashkëpunimit dhe investimeve në këtë komunë. Fillimisht kryetari Bahtiri ka falënderuar të pranishmit për interesimin për të investuar në Kosovë, pastaj i ka njoftuar më pas me kushtet që

ofron Komuna e Mitrovicës për investitorët e huaj. Në fjalën e tij përfaqësuesi për Ballkan, Nasufoski, pasi ia ka dorëzuar biznes-planin kryetarit Bahtiri, e ka njoftuar atë edhe me projektin energjetik i cili ka për qëllim, grumbullimin dhe riciklimin e plehrave dhe prodhimin e energjisë. Nasufoski ka theksuar se ky projekt me rastin e realizimit në qytetin e Mitrovicës parashikon inves-

time mbi 25 milionë euro, ndërsa në nivel të Kosovës rreth 100 milionë euro. Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka bërë me dije se Komuna e Mitrovicës ofron kushte dhe lehtësira shumë të mëdha për të gjithë ata që synojnë të investojnë në projekte të ndryshme, duke përmendur me këtë rast dhënien e tokës falas, pastaj edhe lehtësira të tjera tatimore.

## Marrëveshje mbi 135 mijë euro për 'Shtigjet e ecjes' në Rahovec

**PRISHTINË, 12 PRILL (ER)** - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka nënshkruar marrëveshje të mirëkuptimit për mbështetjen e projektit "Shtigjet e ecjes" me ministrin e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, Rasim Demiri. Sipas kësaj mar-

rëveshje, MZHR-ja këtë vit përkrah financiarisht realizimin e këtij projekti në shumën prej 125 000 eurosh, ndërkaq Komuna e Rahovecit do të ndajë 10 500 euro nga buxheti i saj. "Ndiem mirë që do të bëhet realitet zotimi im publik për t'u



ngjitur me shkallë deri në Majën e Shkodranit. Po ashtu, jam i sigurt se në këtë zonë të patrajtuar deri më tani, në të ardhmen e afërt, pritet të zhvillohen agroturizmi dhe turizmi kulturor", ka thënë kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi. Ai i ka

falënderuar bashkëpunëtorët në komunë që kontribuan për përgatitjen e mirë të projektit, Komunën e Malishevës e cila është pajtuar që Rahoveci të jetë komunë lidere në projekt, si dhe mbështetjen e arsyeshme të stafit të MZHR-së.

## FSK-ja njoftohet me menaxhimin e emergjencave në Komunën e Malishevës

**MALISHEVË, 12 PRILL (ER)** - Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), përkatësisht njësi ndërlidhëse për marrëdhënie ushtarako-civile, e prirë nga majori Rexhep Bytyçi, ka qëndruar të enjten në Malishevë, ku është takuar me kryetarin e Malishevës, Ragip Begaj, drejtorin e për Mbrojtje dhe Shpëtim, Valon Gashi, dhe zyrtarët përgjegjës të DMSH-së. Qëllimi i këtij takimi ishte njoftimi me nivelin e menaxhimit të

emergjencave lokale në Komunën e Malishevës, si dhe mundësinë për bashkëpunimin me njësitë reaguese të FSK-së, në rastet e situatave emergjente. Kreu i Malishevës e ka falënderuar njësinë e FSK-së për përkushtimin për zbatimin e detyrave për mbrojtje të jetës së qytetarëve, në raste të situatave të krizave apo emergjencave dhe gatishmërisë së FSK-së, për të bashkëpunuar me nivelin

lokal, për menaxhimin e emergjencave eventuale. Ndërsa drejtori komunal për Mbrojtje dhe Shpëtim, Valon Gashi, i ka njoftuar me gjendjen e përgjithshme në Malishevë, për situatat emergjente të cilat janë paraqitur gjatë këtij viti, përkatësisht përmbytjet e shkaktuara dhe menaxhimin e këtyre situatave, të cilat janë menaxhuar mirë nga ana e pushtetit komunal.



# Në luftën e Kosovës kishte vetëm një UÇK



**Jakup KRASNIQI**

Nga Konferenca Ndërkombëtare e Rambujesë, pas pjesës së dytë të mbajtur në Paris, me FARK-istët që mrizonin në Shqipëri kam pasur disa takime në Laprakë të Tiranës dhe u pata

bërë ftesë për të hyrë në Kosovë ku zhvillohej lufta. Në këtë kohë është përgatitur edhe plani për operacionin Shigjeta të cilin e pati udhëhequr ministri i Mbrojtjes, Fatmir Limaj. Para se të hartohet operacioni Shigjeta, unë asokohe si zëdhënës i UÇK-së dhe zëvendëskomandant i saj isha në Tropojë ku ekzistonte një formacion i armatosur që pretendonte të hynte në Kosovë. Në atë kohë veç kishin filluar bombardimet e NATO-s dhe udhëheqësit e atij formacioni ushtarak që më vonë u shndër-

rua në Brigadë pas vrasjes së dëshmorit Agim Ramadani dhe u pagëzua me emrin e tij, Brigada Agim Ramadani. Në këtë formacion edhe kishte pjesëtarë të Farkut të Laprakës, por simbolet e tyre ishin të UÇK-së. Aty kishte edhe shumë pjesëtarë që e kishin themeluar UÇK-në, siç ishte edhe dëshmorit Xhemajl Fetahu, Nasim Haradinaj e shumë të tjerë. E dija historinë e disave, por kur unë isha atje e formova bindjen se ishin shkëputur nga ajo që po e thonë sot. Ndoshta prania ime i kishte bërë atëherë që të hes-

htin. Ky formacion ishte i UÇK-së, individualisht kush si e ka quajtur veten e tij, nuk dua të merrem, se kjo çështje as atëherë e as sot nuk ka ndonjë rëndësi. E rëndësishme është se ishte momenti i fundit që ai formacion t'i arsyetonte shpenzimet financiare që i bënte. Këtij formacioni i është dhënë ndihma e nevojshme dhe e kërkuar nga ShP i UÇK-së. Këtë (ndihmën) mund ta konfirmoj edhe gjenerali (komandanti) i nderuar i Shqipërisë, Kudusi Lame, i cili edhe ka shkruar për këtë çështje.

Veç edhe një gjë dua të them. Sa për farkistët lufta në Kosovë kurrë nuk do të ndodhte. Ata, veç emrit, nuk kishin asnjë aktivitet tjetër. Dhe thirrja sot pas 19 vjetëve në farkizëm nuk i nderon as të rënit e as të gjallët e mbetur. Të gjitha aktivitetet politike, brenda e jashtë atdheut, i kanë bërë drejtuesit e ShP të UÇK-së. Diçka nga këto i kam sqaruar mirë edhe më gjerësisht në librin tim: "Kthesa e Madhe - Ushtria Çlirimtare e Kosovës", botuar në vitin 2006 dhe 2007 nga N. Sh. "Buzuku".

## Kryetari i Deçanit, i kënaqur me investimet e KEDS-it

**DEÇAN, 12 PRILL (ER)** - Me investimet e KEDS-it që kanë ndodhur dhe që po ndodhin në rajonin e Deçanit është i kënaqur edhe kryetari i kësaj komune, Bashkim Ramosaj. Investimet e KEDS-it kanë të bëjnë me rritjen e kualitetit dhe furnizimin stabil me energji elektrike. "Gjatë vitit që lamë pas në komunën tonë, në bazë të statistikave dhe terrenit nga Kompania Kosovare për Distributum dhe Furnizim me Energji Elektrike - KEDS kanë ndodhur investime serioze në rajonin tonë. Trafoja e re me largpërçues ajror është vendosur në fshatin Carrabreg në lagjen Ramosaj. Trafoja e re me investim përcjellës është vendosur në fshatin Baballoq. Trafo të re me largpërçues ajrorë dhe nëntokësorë është vendosur në fshatin Strellc i Ulët. Edhe në Isniq kemi pasur trafo të re me largpërçues ajrorë. Mos të harrojmë se në vitin 2017 ka ndodhur pëlqimi për shfrytëzimin e hapësirave për

ndërtimin, rinovimin e largpërçuesve kabllorë dhe ajrorë që kalojnë në trasenë e zonave kadastrale të Komunës së Deçanit për ta vazhduar trasenë në Komunën e Junikut", ka deklaruar kryetari i Deçanit, Bashkim Ramosaj. Ai ka paralajmëruar edhe një projekt gjigant investiv të KEDS-it në këto anë. "Bëhet fjalë për elektrifikimin e bjeshkëve të Deçanit që drejtpërdrejt ndihmon në zhvillimin e turizmit", ka thënë Ramosaj. Zëdhënësi i KEDS-it, Viktor Buzhala, ka bërë me dije se me investimet e vazhdueshme në Deçan rrjeti elektrik po përmirësohet dukshëm. "Deçani është një nga komunat që ka fokusin e KEDS-it, për arsye se rrjeti i trashëguar në atë pjesë ishte në një gjendje mjaft të rëndë. Por, këtë po e ndryshojmë ditë pas dite me investime të vazhdueshme", ka thënë Buzhala. Sipas tij, këto investime do të vazhdojnë edhe në të ardhmen.



## Nis bashkëpunimi mes UShAF-së dhe Universitetit 'Goce Dellçev' në Shtip



**FERIZAJ, 12 PRILL (ER)** - Rektori i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), prof. dr. Agron Bajraktari dhe rektori i Universitetit "Goce Dellçev" (UGD) në Shtip të Maqedonisë, prof. dr. Blazo Boev, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në fushën e arsimit të lartë dhe shkencës. Kjo marrëveshje shënon një fillim të ri për të dyja institucionet, duke mundësuar shkëmbimin e studentëve, stafit akademik dhe administrativ, si dhe shkëm-

bimin e materialeve akademike e shkencore. Rektori Bajraktari u shpreh kënaqësi që UShAF-ja do të bashkëpunojë me një universitet të famshëm jo vetëm në Maqedoni, por edhe në rajon. "UShAF-ja është universitet publik, i vetmi i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, i cili për 39 vjet ka funksionuar në kuadër të Universitetit të Prishtinës dhe tani kemi dy vjet e gjysmë që jemi të pavarur, të fokusuar në inxhinierinë mekanike, teknologjinë e drurit dhe tur-

izëm. E veçanta e universitetit tonë, e që na dallon nga universitetet e tjera, është se jemi të lidhur ngushtë me industrinë dhe gjithmonë jemi në shërbim të tyre, duke iu përshtatur kërkesave të tregut", ka thënë rektori Bajraktari. Po ashtu, rektori Bajraktari ka theksuar rëndësinë e kësaj marrëveshje. Sipas tij, të dyja institucionet do të mund të aplikojnë në projektet e Erasmus+, duke përfshirë mobilitetin e studentëve dhe stafit.

# Shtetet e Bashkuara dhe konflikti në Siri

Presidenti amerikan Donald Trump tha të enjten se sulmi ndaj Sirisë mund të realizohet shumë shpejt, ose jo së shpejti

WASHINGTON, 12 PRILL - Presidenti amerikan Donald Trump thotë se në asnjë moment nuk përcaktoi ndonjë afat për sulm ndaj Sirisë. Në një postim të enjten në "Twitter", presidenti tha se sulmi "mund të realizohet shumë shpejt, ose jo së shpejti". Po të enjten, presidenti shkruan në "Twitter" se Shtetet e Bashkuara, nën administratën e tij, kanë bërë një punë të mrekullueshme për ta spastruar zonën nga Shteti Islamik.

Presidenti Trump ka reaguar i revoltuar ndaj pamjeve filmike, ku shihen fëmijë duke vdekur, pasi besohet se janë viktime të gazit kimik në një lagje pranë Damaskut. Presidenti e ka quajtur udhëheqësin sirian Bashar al-Assad "një kafshë që vret me gaz kimik" dhe është angazhuar në një shkëmbim akuzash me rusët

që i ofrojnë mbrojtje Assadit. Ky shkëmbim ka krijuar shqetësimin se forcat amerikane mund të jenë në prag të një angazhimi ushtarak me forcat ruse në Siri.

Gerald Feierstein, ish-ambasador amerikan në Jemen, tha për "Zërin e Amerikës" se ka edhe përplasje të tjera që mund të shkallëzohen në konflikt brenda Sirisë. "Ka fërkime mes Izraelit dhe Iranit brenda Sirisë. Po ashtu ekziston mundësia që ShBA-ja dhe Rusia të tërhiqen në një ballafaqim në Siri si rezultat i këtyre zhvillimeve. Po shtohen kërcënimet, si rrjedhojë e kontrollit që ushtrojnë Irani dhe Hezbollahu në zona të Sirisë. Kjo ngre mundësinë e një ballafaqimi kundër Izraelit, po ashtu edhe kundër Jordanisë. Është edhe konflikti mes Turqisë dhe kur-



dëve, që pa diskutim prek interese amerikane", tha ai.

Të mërkurën Shtëpia e Bardhë reagoi, duke thënë se nuk ka plane të finalizuara për një sulm me raketa në Siri. "Ky është një prej opsioneve, por nuk do të thotë që është i vetmi opsion, apo e vetnja gjë që presidenti mund të bëjë," tha zëdhënësjja e Shtëpisë së Bardhë, Sarah Huckabee Sanders.

Por zëdhënësjja e Shtëpisë së

Bardhë konfirmoi se presidenti beson se Rusia është përgjegjëse, pasi ka mundësuar masakrat në Siri. "Ata garantuan se armët kimike nuk do të përdoren më kurrë në Siri. Kanë dështuar në këtë drejtim dhe po ashtu kanë ndihmuar Sirinë duke vënë gjashtë herë veton kundër rezolutave të OKB-së, duke ndihmuar për të mbrojtur Assadin", tha ajo. Si Rusia, ashtu edhe Siria kanë mohuar se është përdorur gaz

helmues në sulmin e së shtunës në Duma.

Sekretari amerikan i Mbrojtjes Jim Mattis tha se ShBA-ja dhe aleatët e tyre ende po analizojnë provat, por shtoi se Ushtria amerikane është e gatshme të veprojë. "Jemi gati të ofrojmë opsione ushtarake, nëse akte të tilla shihen si të përshtatshme nga presidenti", tha ai.

Një analist rus tha se Moska do t'i përgjigjej një sulmi ushtarak amerikan mbi objekte të Qeverisë siriane. "Ky vendim i prerë nga presidenti amerikan për të urdhëruar goditje në Siri ka shumë të ngjarë që të konsiderohet nga Rusia si akt shumë armiqësor," thotë Fiodor Lykianov.

Një vit më parë, presidenti Trump dha urdhër për goditje amerikane ndaj një baze ajrore siriane, nga ku besohet se u ndërmorën sulmet kimike që lanë të vdekur dhjetëra civilë në veri-perëndim të Sirisë. Por analistët thonë se situata në Siri është bërë më e ndërlikuar dhe më e tensionuar që atëherë.

## Laboratorët konfirmojnë përdorimin e agjentit kimik në Britani



LONDËR, 12 PRILL - Katër laboratorë me lidhje me Organizatën për Ndalimin e Armëve Kimike konfirmuan konkluzionin e Britanisë, se për helmimin muajin e kaluar të ish-spiunit rus dhe vajzës së tij është përdorur një agjent kimik. Organizata publikoi të enjten një raport, pas analizave të kryera nga katër laboratorët.

Kryeministrja britanike Theresa May pati thënë se ish-spiuni rus Sergei Skripal dhe vajza e tij Yulia, u helmuan muajin e kaluar në Salisbury të Anglisë, me një agjent nervor që përdoret në ushtri, të krijuar nga Bashkimi Sovjetik në vitet 1970 dhe '80. Organizata Organizatën për Ndalimin e Armëve Kimike nuk fajësoi Rusinë për sulmin dhe as

përmendi një emër specifik të lëndës kimike të përdorur. Por Ministri i Jashtëm britanik Boris Johnson tha se vetëm Rusia i kishte mjetet, motivin dhe njohet historikisht për kryerjen e sulmeve të këtij lloji. Rusia ka mohuar përfshirjen në sulm dhe thotë se Britania nuk ka paraqitur fakte për t'i provuar akuzat e saj.



## Merkeli: Nuk marrim pjesë në një sulm të mundshëm ndaj Sirisë

BERLIN, 12 PRILL - Gjermania nuk do të marrë pjesë në asnjë sulm ajror ndaj Sirisë, në kundërpërgjigje ndaj sulmit të dyshuar kimik në qytetin Duma, ka thënë kancelarja gjermane, Angela Merkel. "Gjermania nuk do të marrë pjesë në ndonjë operacion të mundshëm ushtarak", ka thënë Merkel, gjatë një konference për media në Berlin. "Megjithatë, në mbështetje të gjithë atë që po bëhet për të treguar se përdorimi i armëve

kimike është i papranueshëm", ka shtuar Merkel.

Më 7 prill dhjetëra persona kanë vdekur në Duma të Sirisë, në atë që dyshohet se ka qenë një sulm kimik. ShBA-ja ka fajësuar forcat e Qeverisë siriane dhe Rusinë se e kanë kryer këtë sulm. Presidenti Donald Trump ka paralajmëruar se do t'i kundërpërgjigjet me sulm me raketa Sirisë, por nuk ka treguar se kur mund të ndodhë një gjë e tillë.

## Raund i ri bisedimesh për emrin e Maqedonisë

SHKUP, 12 PRILL - Ministrat e jashtëm të Greqisë dhe Maqedonisë, Nikos Koxias dhe Nikolla Dimitrov u takuan të enjten në Ohër për të vazhduar një raund të ri të bisedimeve për zgjidhjen e problemit të emrit të Maqedonisë. Dy ministrat thanë se po shënohet përparim, por se ende mbeten çështjet më të vështira për t'u zgjidhur. Megjithatë nuk dhanë hollësi, ata lanë të kuptohet se po bisedohet për një kornizë kohore për

zbatimin e marrëveshjes, pasi të arrihej ajo.

Shefi i diplomacisë maqedonase, Dimitrov theksoi se grupet e punës po punojnë në një tekst mbi pengimin e irredentizmit të të dyja palëve.

Ka qenë Greqia ajo që ka ngulur këmbë të sigurohej që vendi fqinj të hiqte dorë nga synimet irredentiste, por Nikos Koxias nuk foli për këtë moment të ri që e bëri të ditur kolegu i tij nga Shkupi. "Siç mund ta kuptoni, sa më shumë që afrohem dhe i

zgjidhin problemet tona, mbeten pak çështje për t'i zgjidhur, por ato janë më të vështirat", u shpreh kryediplomati grek.

Koxias dhe Dimitrov do të takohen sërish më 4 ose 5 maj në Selanik për t'i vazhduar bisedimet.

Pala greke ka lënë të kuptohet, sipas medias në Athinë, se referenca "Maqedonia e Epërme" ose "Veriore" është më e pranueshme për Greqinë, por çështja mbetet tek ajo që quhet 'Erga omnes' (përdorim i



përgjithshëm) që emri i ri të jetë në përdorim të përgjithshëm

edhe ndërkombëtar edhe për vetë republikën ish-jugosllave.

# AUTOSHKOLLA "RITMO - L"



**Auto Shkolla  
"RITMO - L"  
Prishtinë**

**Eksperiencia jonë  
- përfitimi i juaj.**

**Afati i paraqitjes prej 03.03.2018  
deri më 10.03.2018**

**Ju mirëpret:**

**Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:**

**044 248 173**

**044 200 604**

**044 375 333**

**American  
Taste**  
**SINCE  
1905**

**RC  
cola**  
Columbus, Georgia, USA  
2L

**RC  
Refresher  
BITTER  
LEMON**  
2L

**RC  
Refresher  
Lemon Lime**  
2L

# Një vepër studimore që e nderon shkencën e albanologjisë

(Vebi Bexheti, "Magjia e fjalës poetike", Tetovë, 2018)



Prof. dr. Emin KABASHI

## Përkufizimi

Metodologjia e ndërtimit të strukturës së veprës studimore të Vebi Bexhetit, "Magjia e fjalës poetike", është kushtëzuar nga natyra e shkrimeve që ka përfshirë autori në tërësinë e saj. Sado që në shikim të parë, ato duken tema të veçuara, lidhjen organike e krijojnë duke u mbështetur, jo vetëm në çështjet që ka marrë në trajtim, por edhe mënyrën e shkrirjes së tyre në një tërësi specifike, që veprës i jep frymë të një studimi tematik, gjë që në fund, të fundit është kërkesë e të gjitha veprave studimore në fushë të albanologjisë.

## Hyrje

Në të gjitha studimet e veprës së prof. Vebi Bexhetit, "Magjia e fjalës poetike", kanë përcjellës disa të dhëna elementare, që dëshmojnë për njohuritë e metodologjisë së strukturës shkencore të një veprë studimore. Këto karakteristika, nëse mund të quhen të tilla, duke filluar nga studimi i parë që ka përfshirë në veprën e tij, me titull Kur poezia ballafaqohet me politikën, e deri të studimi i fundit, që ka marrë në shqyrtim poezinë e një poetje shumë të veçantë, për nga gjuha e krijimit poetik, për nga ndjeshmëria, si dhe për nga përkushtimi krijues, me titull Poezi me aromën e lules "Iris illyrica" të poeteshës Lindita Ahmeti, studimet e Vebi Bexhetit e kanë në fund, vitin e krijimit dhe literaturën përcjellëse. Qofshin vetëm këto dy argumente, e bindin lexuesin për përkushtimin e studiuesit në planin e informacionit shkencor, si dhe në rrafshin e njohjes së materialit që ka marrë në shqyrtim për studimet e tij.

Temat që ka përfshirë në veprën e tij studimore janë të shumta, por janë karakteristike. Janë të tilla, për faktin se janë përgjedhur me kujdes, se trajtojnë aspekte të caktuar të aktit kri-

jues, të akëcilës periudhë studimore, apo të akëcililit krijues, edhe me afër se kaq, për tema, motive dhe krijues të ndryshëm shqiptarë. Secila nga këto tema, secili nga këto motive, akëcili krijues, që ka marrë në shqyrtim, shpalojnë pjesë të tërësisë së studimit të tij, "Magjia e fjalës poetike". Më thotë mendja, këtu dhe qëndron e veçanta e kësaj veprë studimore.

## Arti i poezisë, zë i kundërt i sistemeve shoqërore

Në studimin e parë të veprës së tij studimore, Kur poezia ballafaqohet me politikën, gjerësia e shqyrtimit të kësaj përballjeje është e madhe dhe përfshinë disa periudha të zhvillimit të saj në gjuhën shqipe. Fillon me poetin më të madh të romantizmit shqiptar, Jeronim de Radën, pastaj me poetin tonë kombëtar, Naim Frashërin, duke ngulmuar që, jo vetëm të shtrojë rrugën e mundimshme të këtij ballafaqimi të artit të poezisë dhe të dhunës së pushtetit, sidomos kur ai është shqyrtojë e të zërthejë përbërësit themelorë të kësaj përballjeje të poezisë shqipe me pushtetet e periudhave të ndryshme kohore.

Studiuesi Vebi Bexheti, duke mos u ndalur në analizimin e strukturës dhe të ndërtimit të poezisë së akëcililit krijues, ka zgjedhur momentet kulmore të realizimeve të tyre poetike, në përballje me politikën, për të dëshmuar, jo vetëm forcën shpirtërore të artit të fjalës, pra magjinë e saj, por edhe ndikimin e saj në vetëdijesimin kombëtar të lexuesve. Andaj, jo rastësisht, në përgjedhjen që ka bërë autori i kësaj veprë studimore, janë prekur kulmet e kësaj përballjeje, duke filluar me përfytyrimin epokal të Jeronim de Radës, se erdhi dita e Arbrit, doemos do vdesim, edhe për ardhjen e saj, duke vazhduar me figurën madhore të poezisë naimiane, se do të shndërrohej në qiri, vetëm për të ndriçuar rrugën e ardhjes, se Ditë më të mira paskëtaj vijnë, e deri të, ndoshta i fundit të romantikëve dhe modernistëve të mëdhenj të poezisë shqiptare, të vargjet e njohura të Lasgush Poradecit, kur mbreti i shqiptarëve i kërkonte të shkruante poezi për mbretërinë e tij. "E ku mundet një poet\ me një copkë poezi/të

lëndoj ty o mbret/ që bëre një mbretëri". As aluzionit, as ironisë, lexuesi i informuar i poezisë shqipe, nuk ka çka i shton këtij shqyrtimi të poezisë shqipe në përballjen me politikën e të gjitha sistemeve shoqërore nëpër të cilat ka kaluar zhvillimi i poezisë shqiptare, që ka marrë në shqyrtim studiuesi Vebi Bexheti.

## Arbëreshët dhe njohja e studimore e krijimtarisë së tyre

Tema të caktuara në shqyrtimin dhe analizën studimore në veprën "Magjia e fjalës poetike", të studiuesit Vebi Bexheti, megjithatë kanë ndonjë nuancë përkushtimi më të veçantë. Kësisoj, fjala vjen, në këtë vepër autori ka tri studime që merren me poezinë arbëreshe. Me poezinë moderne arbëreshe, si gjuhë poetike e identitetit kombëtar, me lirikën deradiane, që figurën e artit gojor e ka ngritur në poezi të mirëfilltë artistike të romantizmit shqiptar dhe e ka bërë moshatare të poezisë romantike evropiane, si tërësinë e ekzistimit të tyre historik, si dhe ka trajtuar praninë e arbëreshëve në poezinë e Martin Camajt.

Përkundër faktit se edhe poezia e sotme shqipe e arbëreshëve të Italisë, krijohet në rrethana krejt të tjera kohore dhe artistike, edhe të zhvillimit të poezisë shqipe në përgjithësi, ajo prapë së prapë, merret me të njëjtat tema dhe motive, siç edhe ajo e periudhave të tjera kohore, që nga romantizmi e epokat e tjera stilistike, nëpër të cilat është zhvilluar poezia shqipe e arbëreshëve.

Andaj, siç ka vërejtur edhe studiuesi më i njohur i krijimtarisë shpirtërore shqiptare të arbëreshëve të Italisë, Francisko Altimari, përkundër të dhënës se këta krijues jetojnë dhe krijojnë të rrethuar nga populli të ndryshme për nga kultura dhe gjuha, ata në poezinë e tyre, të cilën e ka marrë në shqyrtim studiuesi Vebi Bexheti, kanë ruajtur me xhelozji, gjuhën, zakonet, këngët, mallin për atdheun e të parë, si dhe veçori të tjera etnike, siç do të thoshte Altimari, në studimin e tij. (fq. 227-228).

Përkimët, ngjashmëritë, fryma lirike e temave epike, freskia krijuese, janë disa nga karakteristikat themelore që ka shqyrtuar

studiuesi Vebi Bexheti, qoftë duke u mbështetur në mënyrë shteruese në studiues të tjerë, për të nxjerrë përfundime krejt origjinale lidhur me përkatësinë popullore të romanit dyfish të lirik të Jeronim de Radës, "Këngë të Milosaos bir i sundimtarit të Shkodrës". Poeti që ende nuk njihet mirë në të gjitha mjediset shqiptare, Martin Camaj, duke u marrë aq gjatë dhe me aq përkushtim, edhe me studimet për jetën dhe të folmen e arbëreshëve, doemos që i ka pasur frymëzimin edhe për poezinë e tij.

Autori i kësaj veprë studimore, Vebi Bexheti ka analizuar disa nga këto krijime të Martin Camajt, duke specifikuar sidomos modernitetin, por deri edhe hermetizmin, pra vargun e mbyllur të poezisë moderne shqiptare të arbëreshëve të Italisë, në punë të kuptimit apo të deshifrimit të saj.

Poezia Veshje arbëreshe, që jo rastësisht ka këtë titull, dëshmon për përkatësinë e identitetit kombëtar të arbëreshëve, që shënjohej edhe përmes veshjes së tyre me përkatësinë kombëtare që kanë marrë nga atdheu i të parëve.

Kurse në poezinë Pranverë në katundin arbëresh, autori konstaton se gjuha e poezisë së këtyllë të Martin Camajt, është trajton, por edhe për thellësinë e mendimit dhe shkathtësinë e gjuhës, që e bën këtë poezi të përmasës evropiane.

## Lasgushi dhe mbretërit shqiptarë

Pas këtyre temave studimore, vetëm edhe Lasgush Poradecit dhe poezisë së tij ia ka kushtuar dy studime të mirëfillta. Në njërin nga këto studime, ka hedhur poshtë me fakte të strukturës poetike të poezisë së Lasgush Poradecit, dilemën e Kristë Malokut, se a ishte poet Lasgushi ynë, si dhe ka shqyrtuar me akribi shkrimore, dy nga poezitë e tij karakteristike dhe domethënëse, poezinë "Zog i qiejve dhe poezinë "Kënga pleqërishte".

Për poezinë e parë studiuesi mendon se është shenjë identifikuese e poezisë lasgushiane, pa lënë anash vlerat e poezive të tjera, duke paralajmëruar se në poezinë shqipe po vinte një frymë e re e këngëtimit poetik. Në analizën për poezinë Kënga

pleqërishte, autori i studimit është marrë edhe me dilemën, cilën ka pëlqyer Lasgushi: këngën pleqërishte, apo këngën e lashtë të vjershërisë, duke i zërthyer pastaj, edhe sipas mendimit të studiuesve të tjerë, edhe sipas qasjes origjinale që ka përdorur për shqyrtimin e vlerës poetike të këtyre dy poezive të Lasgush Poradecit.

Qofshin vetëm këto dy aspekte të trajtimit të poezisë së poetit tonë modern, dëshmojnë për përkushtimin e studiuesit që të përballet me vlera dhe krijime të tilla, që janë vlerat madhore të artit të poezisë shqipe.

Lumi Drin që ndan dhe bashkon tokat shqiptare

Një studim i mirëfilltë, krejt i veçantë, në veprën studimore "Magjia e fjalës poetike" të autorit Vebi Bexheti, është edhe shqyrtimi analizuës i pranisë së figurës poetike të Lumit Drin në poezinë shqipe. Nuk janë me rëndësi faktet e jashtme, pse autori e ka marrë në shqyrtim këtë figurë në poezinë e shumë krijuesve shqiptarë, por është me rëndësi, se ai ka zërthyer vlera të mirëfillta poetike të poezisë së krijuesve të ndryshëm shqiptarë, në studimin e tij.

Duke filluar me poezinë e Lasgush Poradecit, ku përmendet edhe Drini plak e i përallshëm, për të cilën ndonjëherë poeti është kritikuar nga analistë ideologjik të kohës, studiuesi Vebi Bexheti, ka numëruar edhe autorë të tjerë që e kanë temë të poezisë së tyre, e kanë motiv frymëzimi, Lumi Drin, siç janë Azem Shkreli - "Ti di diçka të kaltër/ e të thellë për etjet tona/".

Kurse Martin Camaj, në poezinë e tij, përveç si hidronim, i jep veti mitologjike, që më thotë mendja, është karakteristike e poezisë së tij me këtë motiv, sepse Lumi Drin, del edhe si dëshmi poetike edhe për lashtësinë dhe identitetin kombëtar të shqiptarëve, pa marrë parasysh, se gjeografia e këtij populli ishte e copëtuar. Andaj, ai e paraqet edhe dhembjen, edhe mallin, ashtu si i ka hije poetit të mirëfilltë: "Zemra më asht e ndame dyshë/dyshë mes dy dhenash/ dyshë mes dy kohash/dyshë mes dy shijeve" (408).

(Vijon)

## Ish-bashkëshortja kërkon më shumë para nga Jesse



**I**sh-bashkëshortja e Jesse Williamsit ka paraqitur dokumente në gjykatë duke kërkuar më shumë para për kujdes ndaj fëmijëve. Aryn Drake-Lee ka thënë se 50 mijë dollarë në muaj që merr aktualisht nuk janë të mjaftueshme për t'i mbuluar shpenzimet e

fëmijëve, njëri katërvjeçar dhe tjetri dyvjeçar. Në dokumentet ligjore Aryn ka thënë se aktualisht me këto të ardhura financiare paguan të gjitha shpenzimet për fëmijë, ushqim, rroba dhe për udhëtimet. Për t'i mbuluar të gjitha këto shifra asaj i duhen 73 mijë dollarë në muaj.



## Rita Ora shtyn publikimin e albumit

**P**ublikimi i albumit të radhës nga Rita Ora është shtyrë përsëri. "Glamour Magazine Germany" ka bërë me dije për shtyrjen e albumit, duke sqaruar se Rita do ta publikojë albumin

në vjeshtë, ndonëse një gjë e tillë ishte paralajmëruar për në pranverë. Arsyeja pse ndodhi kjo shtyrje është se "albumi duhet të kompletohet me gjithçka që meriton për t'u lansuar".

## Idris dhe Sabrina, tejet të lumtur pas fejesës



**I**dris Elba dhe Sabrina Dhowre janë fejuar gjatë xhirimeve të filmit të tij më të fundit "Yardia" në "Rino Kinema" në muajin shkurt. Idris dhe e fejuara e tij Sabrina Dhowre po shijojnë kohën e tyre së bashku, duke qenë tejet të lumtur. Përplot buzëqeshje

çifti janë parë edhe në lansimin e Qendrës së Televizionit BBV, në Londër, të mërkurën në mbrëmje. Idris kishte një dukje të thjeshtë me bluzë dhe pantallona ngjyrë blu të errët të cilat i kishte kombinuar me një palë atlete "Adidas".

## Tristani pranon kërcënime



**F**ansat e Khloe Kardashianit kanë marrë situatën në dorën e tyre pas publikimit të lajmeve për tradhtinë e Tristan Thompsonit. Tristan ka pranuar disa kërcënime me vdekje në llogarinë e vet në "Instagram" nga

fansat e Khloes. "Të urojë të vdesësh për atë çka i ke bërë Khloeit" ishte një ndër komentet. Basketbollisti 27-vjeçar ende nuk ka dhënë ndonjë deklaratë në lidhje me tradhtinë e tij të shumëfishitë, njëjtë ka vepruar edhe Khloe.



<b>Autor:</b> <b>GAZMEND MORINA</b>	TRAJNERI I SHOQAR ITALIAN NË FOTO CONTE	RREGULL NË TË NGRËNË E NË TË PIRË (shq.)	KRYEQYTETI I MAROKUT (pashq.)	EDUARD GRAU	LLOJ SHALE PREJ DRURI ME DY KAPTEJ TË LIDHUR ME BRINJË (shq.)	TOKËS E BUKËS (shq.)	SEKT I VEÇANTË I MYSLIMANËVE	<b>EPOKA ERE</b>	MBIZOTËRIMI	LLOJ PAPANALLI	BËRË GATI
SHËNIM I PLOTË I VENDIT KU BANON NJË NJERI (sh.shq.)								DIRECTED ACYCLIC GRAPH			
LUMË NË SHBA E KANADA ME UJËVARA ATRAKTIVE								NJËSI KOHE FJALË E RËNDË DHE E PAHIJSHME			
BANKË QË OPERON NË KOSOVË					NAPË, RUBË (sh.shq.)						
KRYEQYTETI I KANADASË					FUTBOLLISTI HOLANDEZ RAFAEL ... DER VART			AKTORI PRAPASHTICA (shq.)			
QË IA PRET MENDJA; I SHKATHËT								FLEGËR FUTBOLLISTI ARGJENTINAS HAVIER ..... (INTER)			
ZANORE		AUTOTARGA E TIRANËS	REKRUTI NË PERANDORINË OSMAE LLOJ PIJE ALKOOLIKE							UDINESE MORI, HEJ (pash.)	
OLD TIME RADIO				APROVIM	ATEMATIK, JO TEMOR LLOJ VEGLE MUZIKORE						

<b>EPOKA ERE</b>	KUTI E VOGËL PREJ KARTONI (sh.shq.)	BANOR I VIETNAMIT TË VJETËR	DESPOT	ISH KËNGËTARJA ANGLEZE WINEHOUSE (shqip.)	THEMBRA E KËPUCËS	VENDLINDJA E ODISEUT	BANOR I NJË SHTETI EVROPIAN PA NDONJË DOBI				SHENJA NDERKOMBËTARE PËR KAMION KËNGËTARJA .... SHKODRA		GËZIM I MADH
QË BËHET ME ZJARR TË MADH OSE ME FRYMËZIM TË NGRITUR							GOJËDHËNË (sh.shq.)	BANORËT E NJË SHTETI EVRO-AZIATIK			KUNDREJT MBI	ISMET HASANI HYJNIA E DASHURISË (mit. romake)	
PUNËTOR I TEATRIT TË KUKULLAVE								RRJETËZA E SYRIT TERËSI E TË NGRITURAVE DHE E TË ULURAVE TË TOKËS					ZANORE GODINA MBI LUMË
VIZITIMI QESHARAK									I MALLKUAR PERTËRITËS				
SOLISTJA ... BYTYQI				ALFRED KACINARI METAL I LEHTË E I BUTË, QË PËRDORET NË INDUSTRI			PJESË E LOJËS NË TENIS (shq.) HAPËSIRË E MADHE UJI			QILIM I VOGËL QË SHTROHET ANËS VATRËS AKTORJA AM. .... MILANO (shqip.)			
KËNGËTARJA E FAMSHME .... TARNER					KËNGËTARJA ..... PIREVA SKAJI, QOSHJA						OLIVER TUIST	RIFAT AVDIU QYTET NË KOSOVË	SKICA, PROJEKTI
AGIM TEJECI			NOTË MUZIKORE ENË QËLOI ME GRYKË TË GUERË E ME KAPAK			DEGË E GJUHËSISË QË STUDIOJN PREJARDHJEN E FJALËVE QË I PËRKËT ARABISË							BASHKËT. JO E VJETËR
BASHKËT.		VËLLA I BURRIT FUTBOLLISTI I NJOHUR KALOU					ZANORE SHKRIMTARI AMERIKAN HEMINGWAY		QYTET NË KOSOVË (pashq.) RADIUM, TON				ENI LENOKS BASHKËPUNËTOR
<b>EPOKA ERE</b>	LLOJ SHALE DRURI E LARGOJ NGA VENDI KU KA QENË; E ....						E MBYS ME ARMË KËMBËZ SHKALLE				NJOLLA		
FUTBOLLISTI SPANJOLL .... MARTINEZ (shqip.)					APACHE PORTABLE RUNTIME			PËREMËR VETOR I THAVA				AKTORI FRANCEZ .... DELON (shqip.) KËNGËTARI STAJAJ	
HOV, VRULL					DIKTATORI ITALIAN MUSOLINI KALTRINA (perkdh.)					NËNË (turq.) KOHË (sh.pashq.)			ZANORE THEMELI
QUANTIFIE OBJECTIF NATIONAL				CEREMONI FETARE (sh.shq.) LIGJ (vjet.)					ROCKY MOUNTAIN RACEWAYS JO SHËME			AZEM BEJTA ANNA VISSI	JEVG
SHALQI						SELEN, FOSFOR ALI ALIU				PUNËTOR QË PASTRONTE E RREGULLONTE ODAT KASTRIOT TUSHA			
<b>EPOKA ERE</b>	GAZ QË PËRDORET PËR TË PASTRUAR MIRË PLAGËT AUSTRIA						ZBAVITËS, TËRHEQËS BASHKËT.						ZENEL OSMANI BASHKËT.
ALESANDRO NESTA			AJKA E QUMËSHITIT				VEPËR E KRYER (sh.shq.)					RROJ, JETOJ	



E rrallë

## Mumja e majmunit gjendet e fshehur në katin e 7 të hotelit

Punëtorët që po rinovojnë një ndërtesë të vjetër të Dejttonit në qendër të Minneapolis kanë zbuluar mbetjet e mumifikuara të një majmuni. Ekuipazhet kanë gjetur trupin javën e kaluar në një kanal ajri në katin e shtatë të ndërtesës shekullore.



FOTO E DITES




Një student hedh gaz lotsjellës në prani të policisë gjatë një proteste në Dhaka në Bangladesh. /AP/

E jashtëzakonshme

## Foshnja kineze lind katër vjet pas vdekjes së prindërve

Një foshnje ka lindur në Kinë me anë të "nënës zëvendësuese", katër vjet pas vdekjes së prindërve të tij biologjikë në një aksident me makinë, shkruan "BBC". Çifti, i cili vdiq në vitin 2013, kishte ngrirë në frigorifer disa embrione me shpresën se do të arrinin të bëheshin me fëmijë me anë të metodës "In Vitro".



## BARSOLETA E DITËS



- A e di se 'iPhone' i ri ka aplikacion për dobësim?
- E si funksionon?
- E blen, pastaj nuk ke para për bukë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në ora 14:30

### "BLACK PANTHER"

3D (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 2 orë 15 min

Rolet: Chadwick Boseman, Angela Basset, Michael B. Jordan, Lupita Nyong'o, Martin Freeman, Forest Whitaker, Andy Serkis, etj.  
Regjia: Ryan Coogler



Në ora 17:00

### "PETER RABBIT"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 33 min

Rolet: James Corden, Rose Byrne, Domhnall Gleeson, Sam Neill, Daisy Ridley, Elizabeth Debicki, Margot Robbie, etj.  
Regjia: Will Gluck



Në ora 19:00

### "PACIFIC RIM UPRISING" (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 1 orë 51 min

Rolet: John Boyega, Scott Eastwood, Jing Tian, Cailee Spaeny, Rinko Kikuchi, Burn Gorman, Adria Arjona, Charlie Day, etj.  
Regjia: Steven S. DeKnight



Në ora 21:00

### "RED SPARROW" (R)

Mister/Triller; 2 orë 25 min

Rolet: Jenifer Lawrence, Joel Edgerton, Matthias Schoenarts, Jeremy Irons, Mary-Louise Parker, Charlotte Rampling, etj.  
Regjia: Francis Lawrence



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), fb: Kino ABC.



**DASHI**  
Nuk është se keni arritur të zgjidhni

çështje që ju kanë shqetësuar këto kohë. Kjo gjë ju ka sjell me shume stres se zakonisht.



**DEMI**  
Keni fituar pavarësi morale dhe

financiare nga e shkuara juaj. Për këtë arsye jeni bërë më tolerant dhe më të hapur me të tjerët.



**BINJAKËT**  
Një detaj që po ju merr shumë

kohë dhe po ju mundon sot më në fund do të gjejë zgjidhje. Ju doni të jeni i përkryer dhe do t'ia arrini qëllimit.



**GAFORRJA**  
Keni filluar të keni më shumë

besim tek personat që ju rrethojnë dhe jo gjithmonë shtyheni nga instinkti për të zgjidhur një problem.



**LUANI**  
Nuk keni shumë kohë për mëdyshje

dhe dyshime sot. Njerëzit tuaj të dashur do t'ju kërkojnë ndihmë dhe duhet të jeni të gatshëm pa asnjë rezervë.



**VI R G J Ë R E S H A**  
Keni zgjedhur mënyrën më të

thjeshtë për të mos pranuar ndjenjat tuaja, duke shmangur një person të caktuar. Do të pendoheni më vonë.



**PESHORJA**  
Komunikimi është shumë i rëndësishëm sot.

Nëse nuk bisedoni si me kolegët ashtu edhe me partnerin, çështjet e mbartura nuk do të gjejnë zgjidhje.



**AKREPI**  
Një person ka krijuar një ide të

gabuar për ju që nuk i korrespondon realitetit. Nëse doni të sqaroheni, mund ta ftoni për një takim.



**SHIGJETARI**  
Keni vënë baza të forta për të ardhmen

tuaj profesionale dhe jeni mjaft të qetë ndaj çdo ndryshimi që mund të ndodhë.



**BRICJAPI**  
Duhet t'i mirëkuptoni

pjesëtarët e familjes sot që nuk do të aprovojnë një vendim tuajin që dashje pa dashje i kushtëzon edhe ata.



**UJORI**  
Nuk keni zgjidhje tjetër sot përveçse

të merrni në dorë situatën dhe të mundoheni t'i zgjidhni ngërçet e krijuara sepse mund t'ju prishin punë.



**PESHQIT**  
Keni qenë shumë të ndjeshëm

ndaj ngjarjeve dhe personave që keni pasur pranë, por tashmë keni ndryshuar qëndrim nisur nga një situatë e caktuar.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

ASTON VILLA - LEEDS

GG3+

GIRONA - REAL BETIS

3+

WOLFSBURG - AUGSBURG

1


## Drejtuesit e KOK-ut sot vizitojnë Gjilanin dhe Dardanën

**PRISHTINË, 12 PRILL** - Në kuadër të takimeve të shumta me kryetarët e komunave, bizneset dhe klubet sportive, drejtuesit e Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), presidenti Besim Hasani dhe sekretari i përgjithshëm, Shasivar Haxhijaj, të premtën do të qëndrojnë në Gjilan dhe Dardanë. Hasani dhe Haxhijaj do të takohen me kryetarët e këtyre komunave, bizneset dhe klubet. "Me kryetarin e Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, takimi do të mbahet në orën 9:30 në zyrën e tij, kurse me bizneset dhe klubet e kësaj komune, në orën 10:00 në sallën e komunës. Takimi me kryetarin e Dardanës, Qëndron Kastrati, pritet të mbahet në orën 14:00, kurse më pas (14:30) do të takohen bizneset dhe klubet, me të cilat takimi mbahet në sallën e kësaj komune", thuhet në njoftimin e KOK-ut. Me kryetarët e komunave, KOK-ut

prit të nënshkrujë memorandum bashkëpunimi, në bazë të të cilit këto dy komuna do të bëhen bashkëfinancuese me KOK-un për bursistët e Gjilanit dhe të Dardanës, të përzgjedhur nga BE i KOK-ut, kandidat për ta fituar normën olimpikë "Tokyo 2020". Karateistja Fortesa Orana është nga Gjilani, kurse atletët Musa Hajdari, Vjona Kryeziu dhe Astrit Kryeziu vijnë nga Dardana. Bizneseve dhe klubeve do t'u sqarohet në detaje rregullorja që përcakton kriteret, procedurat dhe formën për vërtetimin e sponsorizimit në sport, pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Sponsorizim. Ditë më parë drejtuesit e KOK-ut zhvilluan takime edhe me kryetarët, me atë të Komunës së Pejës, të Burimit, të Klinës, të Mitrovicës dhe të Vushtrrisë, si dhe me bizneset e klubet e këtyre komunave.



## Pajisje sportive për shkollat e Malishevës



**MALISHEVË, 12 PRILL** - Në Komunën e Malishevës këto ditë ka filluar furnizimi me mjete për sallat e sportit në disa nga shkollat në të cilat janë ndërtuar edhe sallat e sportit. Furnizimin me pajisjet për sallat e sportit është duke e realizuar Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. Pajisjen me këto mjete të enjten e kanë parë nga afër i pari i

Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori i Arsimit, Blerim Thaçi.

Kryetari Begaj dhe drejtori Thaçi janë ndarë të kënaqur me këtë furnizim që është duke bërë në sallat e sportit, të cilat janë ndërtuar dhe janë në funksion të nxënësve. Ndërtimi i sallave të sportit është bërë në kuadër të plotësimit të kushteve për

mësimdhënie dhe mësim-nxënie, edhe në lëndën e edukatës fizike dhe është një nga standardet që gradualisht është duke u realizuar në shkollat e Komunës së Malishevës. Aktualisht po furnizohen me pajisje sallat e sportit në Damanek dhe në Banjë, në të cilat, krahas objekteve të reja shkollore, janë ndërtuar edhe sallat e sportit.

## Fillojnë përgatitjet për Javën Evropiane në Sport

**PRISHTINË, 12 PRILL** - Mbledhja e Këshillit për Organizimin e Javës Evropiane në Sport është mbajtur të enjten. Java Evropiane në Sport do të organizohet prej 23-30 shtatorit 2018. Konferenca Femra dhe Sporti, Panairi i Sportit në, së paku 10 komuna, Miniolimpiada për persona me aftësi të kufizuara, aktivitetet nga sporti shkollor dhe ai universitar, çiklizmi dhe atletika,

janë vetëm disa nga aktivitetet që do të organizohen në kuadër të kësaj jave. Me vendim të ministrit për Kulturë, Rini dhe Sport, Kujtim Gashi, Këshilli Organizativ përbëhet nga zyrtarë të MKRS-së, sekretari i përgjithshëm i Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), Shasivar Haxhijaj, përfaqësues të Komitetit Paraolimpik të Kosovës dhe drejtues të federatave.



## Hyseni, trajner i Gjilanit

**GJILAN, 12 PRILL** - Skuadra e Gjilanit ka ardhur me njoftim zyrtar për pasardhësin e trajnerit të dorëhequr, Arbnor Morina.

Klubi kuqebardhë ka bërë me dije se ndihmësi i Morinës, Alban Hyseni, i është besuar puna e trajnerit. "Kryesia e

Klubit e Futbollit të Gjilanit ka vendosur që postin e trajnerit të klubit t'ia besojë ish-lojtarit dhe, së fundmi, ndihmëstrajnerit

Alban Hyseni. Kujtojmë se ish-mbrojtësi gjithë karrierën sportive ia kushtoi SC Gjilanit. Hyseni qysh nesër do të startojë

me punën si kryetrajner, ku ekipi i Gjilanit takohet me skuadrën e Feronikelit në Gjilan", thuhet në njoftimin e Gjilanit.

## Robbery rinovon me Bayernin deri në 2019-n

**MUNCHEN, 12 PRILL** - Tashmë është vulosur, Bayern Munchen ka rinovuar me dyshen legjendare Arjen Robben dhe Franck Ribery edhe për një sezon tjetër. Sipas informacioneve të "Sport Bild", përveç rinovimit të Franck

Ribery (35 vjeç) është arritur marrëveshja për shtyrjen e bashkëpunimit edhe me Arjen Robben (34-vjeç). Dy heronjtë e tripletës të vitit 2013 kanë rinovuar për një sezon tjetër, pra deri në 2019-n. Drejtuesit thuhet ta kenë dhënë verdiktin

final të tyre për rinovimet. Ribery dhe Robben së fundmi kanë qenë të pakënaqur për zvarritjet e negociatave. Por, më në fund, tashmë është sqaruar gjithçka dhe karriera e tyre do të vazhdojë të jetë në Munchen. Të dy veteranët

kanë pasur oferta të shumta, sidomos nga klubet kineze. Por dëshira e tyre ka qenë gjithmonë të qëndronin në Munchen dhe tashmë u është plotësuar dëshira. Pritet që gjithçka të zyrtarizohet brenda dy javëve të ardhshme.



## U16-shet e femrave pësuan humbje nga Irlanda e Veriut



**PRISHTINË, 12 PRILL** - Përfaqësuesja e Kosovës U16 në konkurrencën e femrave e ka zhvilluar ndeshjen e parë në kuadër të Turneut Zhvillimor që po mbahet në Irlandën e Veriut nën përkuqjesdjen e UEFA-s. Vashat e drejtuar nga Kushtrim Munishi në sfidën e parë të këtij turneu kanë pësuar humbje me rezultat 1-5 nga kombëtarja nikoqire e këtij turneu. Megjithatë, loja e vashave tona ka qenë në nivel të mirë dhe kreative,

mirëpo fakti se kombëtarja e kësaj grupmoshe sapo është formuar dhe mungesa e përvojës në ndeshje të këtij niveli bëri që disa gabime në mbrojtje të kushtojnë në rezultat të tillë.

Golat për Kombëtaren e Irlandës së Veriut i shënuan Casey Howe (17), Joely Andrews (35), Cora Chambers (43) dhe Teegan Lynch (76), derisa golin e vetëm për Kombëtaren tonë e shënoi Rrezona Ramadani (45).

Përzgjedhësi Munishi u dha mundësi për lojë të gjitha futbollisteve që kishte në dispozicion, për t'u kalitur për të ardhmen për sfidat e tilla ndërkombëtare. Ndeshjen e radhës vashat tona do ta luajnë të premtën kundër Ishujve Faroe, në orën 16:00.

### Kosova ngjitet 24 pozita në renditjen e FIFA-s

Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka bërë përparimin më të madh në renditjen e FIFA-s që nga anëtarësimi në shtypinë botërore të futbollit. Dy fitoret e realizuara në miqësoret e muajit mars kundër Madagaskarit dhe Burkina Fasos kanë ndikuar që Kosova ta përmirësojë pozitën për 24 vende në renditjen e re të publikuar nga FIFA. Tani Kosova renditet në pozitën e 152-të me 164 pikë të grumbulluara.

## Përcaktohen çiftet e fazës 'play-off'-it

Houston, 12 prill - Ka përfunduar sezoni i rregullt dhe janë përcaktuar të gjitha çiftet e "play-off"-it në kampionatin amerikan të basketbollit, NBA. Në Perëndim, Houston Rockets do të ndeshet me Minnesota Timberwolvesin dhe Golden State Warriorsin me San Antonio Spursin. Portland Trail Blazersi, me fitoren ndaj Utah Jazzit, u rendit në vendin e tretë të Perëndimit dhe do të përballet me New Orleans Pelicansin. Humbja e Jazzit bëri që ky ekip të luajë tashmë me Oklahoma City Thunderin. Ndërkohë, në Lindje, Philadelphia 76ers përfundoi në vendin e tretë dhe do të ndeshet me Miami Heatin, ndërsa Cleveland Cavaliersi do të përballet me Indiana Pacersin. Kuadri i "play-off"-it plotësohet me Boston Celtics - Milwaukee Bucks dhe Toronto Raptors - Washington Wizards.



## Ronaldo mposht Messin, vendos rekord të ri në LK

Penalltia në kohën shtesë e Cristiano Ronaldos, të mërkurën, e dërgoi Real Madridin në gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve dhe krijoi një tjetër rekord për yllin e Portugalisë, në garë. Me Real Madridin që vinte nga avantazhi 3-0 ndaj Juventusit në çerekfinalen e parë të Championsit, por e pa veten në humbje 3-0 në kthimin në shtëpi (barazim 3-3, në total), Ronaldo ktheu në golin e kualifikimit një penallti të diskutueshme, në minutën e 97, në "Santiago Bernabeu". Goli që shënoi kundër Wojciech Szczesny, pasi Gianluigi Buffon ishte nxjerrë me karton të kuq nga, ndoshta, ndeshja e tij e fundit në Ligën e Kampionëve, ishte i 10-ti i Ronaldos në karrierë, kundër Juves, në Ligën e Kampionëve. Kjo shifër është më shumë se e çdo lojtari tjetër kundër një kundërshtari të veçantë në këtë



kompeticion. Para ndeshjes, Ronaldo e ndante rekordin me Lionel Messin, i cili ka shënuar 9 gola kundër Arsenalit në Ligën e Kampionëve. Portugezi shënoi tre nga katër golat e Real Madridit në çerekfinale, me një dopietë të mahnitshëm në ndeshjen e parë, duke i vendosur "Los Blancos" në rrugën e mbrojtjes së kurorës së kampionit të Evropës. Por, tre golat e Juves të mërkurën treguan se heroizmi i Ronaldos u kërkuar sërish për Real Madridin. Goli i 33-

vjeçarit ishte i 15-ti i tij në Ligën e Kampionëve, në sezonin 2017-2018, një shifër që e ka arritur në vetëm 10 ndeshje. E pabesueshme, por Ronaldo është i vetmi lojtar që ndonjëherë arrin të shënojë 15 gola në një sezon të vetëm të Championsit. Dhe ai e ka bërë këtë tri herë. Ronaldo, gjithashtu, u bë i pari lojtar në historinë e Ligës së Kampionëve që shënon në 11 ndeshje të drejtpërdrejta në këtë garë. Ai, gjithashtu, u bë lojtari i tretë që arrin 150 paraqitje në Ligën e Kampionëve, pas ish-portierit të Real Madridit, Iker Casillas (167) dhe ish-mesfushorit të Barcelonës, Xavi Hernandez (151). Real Madridi do të përballet me Liverpoolin, Romën, ose Bayern Munichun në gjysmëfinale, pasi gigantët e La Ligës do të shkojnë për titullin e tretë të Ligës së Kampionëve.

### SHKURT

#### Buffoni deklaron tërheqjen

Reali i mallkuar, penalltia e mallkuar, Champions i mallkuar: Buffoni nuk e arriti dot dhe me shumë gjasa kjo ka qenë mundësia e tij e fundit për ta ngritur lart trofeun e vetëm që i mungon në karrierën e tij brilante. Penalltia e dhënë në minutat shtesë ishte si sinori i fundit i një rrugëtimi të papërsëritshëm. Fundi është gjithnjë i dhimbshëm, aq më shumë kur ke bërë gjithçka në mënyrë të përkryer. Ashtu ishte Juventusit për 90 minutat e kthimit ndaj Real Madridit. Më pas ajo manovër agresive e Benatias, këputja e Vasquezit dhe fërshëllima therëse e arbitrit. Gjithçka më pas është një zhgënjim, për Juventusin që humbet mundësinë e radhës, por më shumë për Buffonin që nuk ka më kohë të provojë përsëri. Në një intervistë për "Juventus Channel", Buffoni lëshoi edhe deklaratën e dhimbshme: "Më vjen keq të lë këta djem të shkëlqyer, por besoj se kam arritur t'i transmetoj diçka". Nuk është ndoshta zyrtare por, ndoshta, jemi një shkallë përpara lamtumirës së Buffonit nga futbollit.

#### Williani refuzon Barcelonën dhe Unitedin

Anëtori brazilian Willian po kërkohet nga Barcelona e Manchester Unitedi, por thotë se është i lumtur te "Blutë e Londrës". "Më pëlqen Premierliga. Më pëlqen Chelsea. Ëndrra ime ka qenë të luaj për Chelsean, kështu që është ëndërr e bërë realitet", ka thënë Williani për "Daily Mail". "Për mua, Premierliga është liga më e fortë në botë dhe Londra është qytet i shkëlqyer. Familjes sime i pëlqen të jetoj këtu. Pas Brazilit, Londra është qyteti im i preferuar, më pëlqen edhe mua të jetoj këtu. Bëra zgjedhjen e duhur kur vendosa të vij te Chelsea sepse tashmë kam fituar dy Premierliga si dhe Kupën në pesë vjet", ka deklaruar Williani.

#### Heynckes nuk ka preferencë për kundërshtarin e gjysmëfinale

Trajneri i Bayern Munichut, Jupp Heynckes, nuk ka preferencë në lidhje me kundërshtarin e shortit në gjysmëfinalen e Ligës së Kampionëve. Ai ka thënë se secila ndeshje do të jetë e vështirë. "Asnjë trajner nuk ka ndonjë preferencë. Shikojeni çfarë i ndodhi Barcelonës. Ndeshjet do të jenë të barabarta", ka deklaruar Heynckes.

#### Kloppi: Salah ndihet rehat në Liverpool

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, nuk është i shqetësuar lidhur me thashethemet për largimin e Mohamed Salah në fund të këtij sezoni nga "Anfield". Ylli egjiptian është afër të bëhet lojtari i parë i "The Reds" që shënon 40 gola në një sezon, që nga koha e Ian Rushit në vitin 1980. Salah është duke u kërkuar nga gjiganti spanjoll, Real Madrid, por Kloppi thotë se nuk është i shqetësuar me thashethemet të tilla. "Unë e di se Mohamed ndihet shumë rehat këtu. Ai e di se stili ynë i lojës i përshtatet shumë mirë atij. Kështu që unë nuk jam i shqetësuar për këtë çështje", ka thënë Kloppi.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë  
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-149, Rregullore Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë bën:

### REKRUTIM

Institucioni: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm

Titulli i vendit të punës: Zyrtar i lartë ekzekutiv

Koeficienti: 8

Nr. i Referencës: MTI/2

Numri i zyrtarëve që do të pranohen: 1

Vendi: Prishtinë

Datë: 13.04.2018

#### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Koordinon aktivitetet e zyrës së SP dhe angazhohet për mbarëvajtjen e punës në zyrën e SP;
- Koordinon planet e punës së departamenteve/divizioneve të miratuara në përputhje me ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afatëve kohore të caktuara;
- Ndihmon në realizimin e objektivave të zyrës së SP;
- Bën analiza, vlerësim të opsioneve dhe rekomandime për shqyrtim nga SP rreth detyrave ose projekteve të ndryshme që ndërlihen me departamentet/divizionet e MTI-së;
- Ofron këshilla për stafin e nivelit më të ulët brenda njësisë organizative për ekzekutimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre;
- Ofron këshilla në fushën e ekspertizës të kërkuar brenda institucionit;
- Koordinon punën me pjesët tjera të institucionit dhe komunikon, sipas nevojës, me autoritetet e jashtme;
- Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

#### Kualifikimet për këtë vend të punës:

- Diplomë Universitare: Administratë Publike, Ekonomik, Juridik;
- Minimum 3 vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri të thellë dhe të specializuar në fushën e administratës shtetërore;
- Njohuri të ligjeve dhe rregullore të aplikueshme;
- Shkathësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, PowerPoint, Access).

#### Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e lartë dhe kanë aftësi profesionale për kryerjen e detyrave.

#### Kohëzgjatja e emërimit:

Nëpunësi i karrierës (përhershëm) Periudha provuese .Dymbëdhjetë (12) muaj.

#### Data e mbylljes së konkursit:

27.04.2018

#### Paraqitja e kërkesave

Formularët për aplikim mund të merren në recepcion të MTI-së, ose të tërhiqen nga web faqja e MTI-së, ku është bërë edhe shpallja e konkursit , në adresën [www.mti-ks.org](http://www.mti-ks.org) dhe dorëzohen në Divizionin e Burimeve Njerëzore, çdo ditë pune nga ora 8:00 -16:00 deri më:27.04.2018.Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr. tel. 038-200 36-578.

*“Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”.*

*“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcionalitet organet e shërbimit civil të administratës publike,qendrore dhe lokale,siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3të Ligjit Nr.03/L-149 mbi shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”*

Kërkesat edërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar,vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë  
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

U skladu sa odredbama Zakona o Civilnoj Službi Republike Kosova Zakon Br. 03/L-149, Uredba Br. 02/2010 o Procedurama Rekrutacije u Civilnoj Službi Republike Kosova Ministarstvo Trgovine i Industrije obavlja:

### REGRUTOVANJE

Institucija: Ministarstvo Trgovine i Industrije

Kancelarija Generalnog Sekretara

Naziv radnog mesta: Viši Izvršni Službenik

Koeficijent: 8

Br. Referencije: MTI/2

Broj službenika koji će biti prihvaćeni: 1

Mesto: Prishtina

Datum: 13.04.2018

#### Obaveze i odgovornosti:

- Koordinira aktivnosti kancelarije GS i uključuje se u tok rada kancelarije GS;
- Koordinira planove rada departmana / odelca usvojenih u skladu sa relevantnim zakonima, propisima, politikama i procedurama, u određenim vremenskim rokovima;
- Pomaže u postizanju ciljeva kancelarije GS;
- Sprovodi analizu, procenu opcija i preporuke za razmatranje od strane GS o raznim obavezama ili projektima koji se odnose na departmane / odjeljenja MTI-a;
- Pruža savete nižem nivou osoblja u organizacionoj jedinici za izvršavanje njihovih dužnosti i odgovornosti;
- Pruža savete u oblasti ekspertize koja se zahteva u okviru institucije;
- Koordinira rad sa drugim delovima institucije i komunicira, prema potrebi, sa vanjskim vlastima;
- Obavlja i sve druge obaveze u specifičnoj profesionalnoj oblasti u skladu sa važećim zakonima i propisima, koje se razumno mogu povremeno zahtevati.

#### Kualifikimet për këtë vend të punës:

- Univerzitetska Diploma: Fakultet Javne Uprave, Ekonomski Fakultet, Pravni Fakultet;
- Minimum 3 godine radnog iskustva u struci;
- Duboko i specijalizovano znanje u oblasti državne uprave
- Poznavanje primenljivih zakona i propisa;
- Veštine u komunikaciji, planiranju rada i vođenju tima
- Istraživačke, analitičke i ocenjivačke veštine i formulisanje stručnih preporuka i saveta;
- Kompjuterske veštine u softverskim aplikacijama (Word, Excel, Power Point, Access).

#### Uslovi učesća u regrutovanju:

Pravo apliciranja imaju svi punoletni građani Republike Kosovo koji imaju punu poslovnu sposobnost, imaju visoku školsku spremu i stručnu sposobnost za obavljanje obaveza.

#### Trajanje imenovanja:

Službenik karijere (stalni). Probni period dvanaest (12) meseci.

#### Datum isteka konkursa:

27.04.2018

#### Podnošenje prijava

Obrazac za apliciranje možete preuzeti na recepciji MTI-a, ili preuzeti u web-stranici MTI-a, gde je i objavljen konkurs, na adresu [www.mti-ks.org](http://www.mti-ks.org) i dostavljaju se Diviziji za Ljudske Resurse, svakog radnog dana od 8:00 -16:00 časova, do: 27.04.2018. Za detaljnije informacije možete kontaktirati broj tel. 038-200 36-578.

*“Civilna Služba Republike Kosovo, pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i pozdravlja aplikacije svih osoba muškog i ženskog pola svih zajednica na Kosovu”.*

*“Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravično i proporcionalno zastupljenost organi civilne službe javne, centralne i lokalne administracije, kao što je navedeno u Članu 11, stav 3 Zakona Br.03 / L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosovo”*

Zahtevi pristigli nakon određenog roka i nepotpuni zahtevi neće biti prihvaćeni.

Zbog velikog broja primljenih prijava biće kontaktirani samo kandidati sa užeg spiska.





**Republika e Kosovës**  
 Republika Kosova - Republic of Kosovo  
 Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*  
 Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja  
 Ministry of Environment and Spatial Planning

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë  
 për Kushtet Ndërtimore  
 “Parku i Energjisë me Erë –SELAC-1” – Komuna e Mitrovicës**

Në bazë të Nenit 13.1 të Udhëzimit Administrative nr.16/2014 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin “Parku i Energjisë me Erë –SELAC-1” – Komuna e Mitrovicës

Nr. prot: 1358/18 të datës 09.03.2018, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda njëzet ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor  
 Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit  
 Divizioni i Planifikimit Hapësinorë  
 Ndërtesa e Rilindjes  
 Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Raporti mund të shkarkohet nga linku i mëposhtëm:

<http://mmp-h-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor  
 Suzana.goranci@rks-gov.net  
 Telefon: + 381 38 200 32 553



**Republika e Kosovës**  
 Republika Kosova - Republic of Kosovo  
 Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*  
 Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja  
 Ministry of Environment and Spatial Planning

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë  
 për Kushtet Ndërtimore  
 “Parku i Energjisë me Erë –SELAC-1” – Komuna e Mitrovicës**

Në bazë të Nenit 13.1 të Udhëzimit Administrative nr.16/2014 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin “Parku i Energjisë me Erë –SELAC-1” – Komuna e Mitrovicës

Nr. prot: 1357/18 të datës 09.03.2018, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda njëzet ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor  
 Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit  
 Divizioni i Planifikimit Hapësinorë  
 Ndërtesa e Rilindjes  
 Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Raporti mund të shkarkohet nga linku i mëposhtëm:

<http://mmp-h-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor  
 Suzana.goranci@rks-gov.net  
 Telefon: + 381 38 200 32 553



**Republika e Kosovës**  
 Republika Kosova-Republic of Kosovo  
 Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*  
 Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja  
 Ministry of Environment and Spatial Planning

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë për Kushtet Ndërtimore  
 “Parku i Energjisë me Erë –SELAC-1” – Komuna e Mitrovicës**

Në bazë të Nenit 13.1 të Udhëzimit Administrative nr.16/2014 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin “Parku i Energjisë me Erë –SELAC-1” – Komuna e Mitrovicës

Nr. prot: 1359/18 të datës 09.03.2018, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda njëzet ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor  
 Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit  
 Divizioni i Planifikimit Hapësinorë  
 Ndërtesa e Rilindjes  
 Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Raporti mund të shkarkohet nga linku i mëposhtëm:

<http://mmp-h-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor  
 Suzana.goranci@rks-gov.net  
 Telefon: + 381 38 200 32 553



**Republika e Kosovës**  
 Republika Kosova-Republic of Kosovo  
 Qeveria - Vlada - Government  
 Ministria e Drejtësisë-Ministraskvo Pravde-Ministry of Justice



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agjencia za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom / Agency for Administration of Sequestered and Confiscated Assets

**Ftesë për Ankand Publik**

**Datë 12.04.2018**

**Referenca: AAPSK- 003/2018**

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Sasia/copë	Çmimi Fillestar/copë	Çmimi nga ofertuesi	Çmimi total €
1	VW Golf II viti i prodhimit 1985 benzinë,ngjyre e bardhë, me targa vendore	1 copë	170.00€		
2	Audi 100 Quatro, viti i prodhimit 1991 dizel, me ngjyrë të bardhë, me targa vendore	1 copë	550.00€		
3	VW Passat viti i prodhimit 1987 benzinë,ngjyre e kuqe, me targa vendore	1 copë	350.00€		
4	Mercedes Model 310 (furgon), viti i prodhimit 1992, me ngjyrë të portokalltë/ për auto-pjesë	1 copë/ auto-pjesë	250.00€		
5	Ford Escor viti i prodhimit 1990 benzinë, ngjyre e bardhë - për skrap	1 copë/skrup	83.20		
6	Shtepiza te kompjuterit (IIP dhe IIP) per pjesë	2 copë/ per pjesë	40.00€		
7	Telefona mobil (3copë) Telefon Samsung GT- S 3850; Samsung GT -S 5260 dhe Blu-Jenny TV 2.8 (te përdorur)	3 copë	9.00€		
8	Shtepiza te kompjuterit (IIP dhe Lenov) per pjesë	2 copë/ per pjesë	40.00€		

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohen më së largu deri më 19.04.2018 në ora 10:00h, në lokalet e AAPSK-së, Divizioni i Shitjes (në adresën e poshtëshënuar). Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: 16.04.2018, prej orës 10:00-11:00 në Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë.

Pasurit e konfiskuara në këtë procedurë shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se,në: <https://md.rks-gov.net/> Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Divizioni i Shitjes; ofrta mos të hapet para orës 10:00.

Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 18 051.

U bë një vit pa më të dashurën tonë



## Hasime (Dragaj) Mulaku

(23.02.1931 - 13.04.2017)

U bë një vit e ne nuk po pajtohemi me realitetin e hidhur që nuk gjendesh më në mesin tonë, por tiparet dhe vlerat e tua të larta njerëzore na bëjnë të fortë kundrejt dhembjes së madhe që kemi për ty. Do të kujtojmë çdo ditë me mall, dashuri, respekt dhe krenari që të patëm. Gjithmonë do ta kesh vendin në zemrat tona.

**E përkujtojnë me shumë mall: bashkëshorti Selmani me familjen Mulaku nga Buroja e Skenderaj.**



### SHPLLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

**Titulli:** Zyrtar për prokurime

**Departamenti:** i Administratës

**Divizioni:** i Prokurimeve

**Grada:** 6

**Raporton tek:** Udhëheqësi i Divizionit

**Përgjegjësitë dhe detyrat e punës:**

- Koordinon përgatitjen e dokumentacionit për çdo prokurim sipas kritereve të parapara;
- Mban evidencë adekuate të tërë procesit prokurues për secilin prokurim dhe në bazë të kësaj përgatit raporte përkatëse mbi aktivitetet prokuruese;
- Kujdeset për përgatitjen e hapjeve publike të tenderëve si dhe përgatitjen e procesverbalëve dhe dokumenteve tjera përcjellëse;
- Kujdeset për përgatitjen e dokumentacionit për shpallje si: njoftimeve për kontratë, njoftimeve për dhënie të kontratës, njoftimeve për anulimin e kontratës, etj. si dhe koordinon afatet kohore në përputhje me rregulloren e prokurimit;
- Asiston në formimin e komisioneve për hapje dhe vlerësim të ofertave në përputhje me rregullat e prokurimit;
- Bën përgatitjen e kontratave dhe kushteve të kontratave;
- Përgatit evidencën mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore lidhur me prokurimet dhe raporte të tjera lidhur me prokurimet;
- Kryen detyra tjera të lidhura me prokurimet varësisht sipas kërkesës së mbikëqyrësit.

**Njohuritë e kërkuara:**

- Diplomë universitare në fakultetin Juridik;
- Njohuri të mira të punës me kompjuter;
- Njohja e gjuhës angleze e preferuar.

**Përvoja e kërkuar:**

- Së paku tri vitepërvoja pune profesionale relevante, nga këto minimum një vit përvojë nëprokurime.

**Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:**

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letërën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga organizata kompetente;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura/nostrifikuar zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë;

**Procedura e aplikimit:**

- Afati i fundit për aplikim është **27 prill 2018**.
- Aplikimi mund të bëhet on-line (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së, nr.22. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)
- Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.

### >> SHPLLJE TË VOGLA <<

► Laura Salihu shpall te pavlefshme dëftesat e kl - V SHF "Abdyl Frasheri" Prizren

► Isuf Hoxha shpall te pavlefshme diplomën e Medresesë "Alaudin" Prishtinë

► Mesret Sylejmani shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren

► Harbin Selimi shpall te pavlefshme dëftesat SHMLM "Luciano Motroni" Prizren

► Shehrije Shala shpall te pavlefshme deftesat dhe diplomën e shkollës së mesme "Skenderbeu" Drenas.

► Lumturije Shala - Rraci shpall te pavlefshme deftesat e shkollës fillore "Abedin Rexha" Turqifc - Skenderaj.

► Arton Thaçi shpall te pavlefshme deftesat e shkollës fillore "Abedin Rexha" Turqifc - Skenderaj.

► Beqir Ramaj shpall te pavlefshme deftesat e shkollës fillore "Abedin Rexha" Turqifc - Skenderaj.

► Besnik Shala shpall te pavlefshme deftesat e shkollës fillore "Abedin Rexha" Turqifc - Skenderaj.

► Fitim Mecinaj shpall te pavlefshme diplomën e shkollës së mesme gjimnazi "Hamzë Jashari" Skenderaj.

► Shkelzen Sylaj shpall te pavlefshme diplomën e shkollës së mesme gjimnazi "Hamzë Jashari" Skenderaj.

► Abdullah Qorraj shpall te pavlefshme diplomën e shkollës së mesme gjimnazi "Hamzë Jashari" Skenderaj.

► Enver Smakaj shpall te pavlefshme diplomën e shkollës së mesme teknike "Anton Çetta" Skenderaj.

► Burim Geci shpall te pavlefshme diplomën e shkollës së mesme teknike "Anton Çetta" Skenderaj.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, truall frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, truall frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshohet me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkohet për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektesë si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshohet banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të

hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkohet një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

► Lëshohet banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkohet kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

► Lëshohet banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshohet banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshohet banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afatë të gjata dhe të shkurtër. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

### URGJENTISHT KËRKOJ BANESË PËR ZYRE ME QIRA

Në qendër të Prishtinës, kërkohet banesë me qira, për zyre. Hapësira 80-100m2.

Kati i -I- deri në katin -III-.  
Tel: **044741155**

Lajmërohen bashkëpronarët e ngastrës kadastrale P-70202016-0440 bk-O, se bashkëpronari Arif Gërxhaliu ka shprehur dëshirën që t'ashë një pjesë të pronës së vet. Andaj njoftohen bashkëpronarët e kësaj parcele kadastrale që nëse janë të interesuar për blerjen e kësaj parcele-pjesën e pronës të lajmërohen te bashkëpronari Arif Gërxhaliu.

### LËSHOJ LOKALIN ME QIRA.

Lokali gjendet në rrugën "Isa Kastrioti" në Matiqan të Prishtinës dhe ka një hapësirë prej 400 m2. Lokali është i gatshëm dhe shumë funksional. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-509-077.

**Urgjentisht kërkohet një shtëpi me qira në Prishtinë. Shtëpia duhet të jetë e veçantë, duhet të ketë 5 ose 6 dhoma gjumi. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel 049-472-770**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës  
Ministarstvo za Kosovske Bezbednosne Snage – Ministry for the Kosovo Security Force



# BËHU KADET I FSK-së! BËHU OFICER I REPUBLIKËS SË KOSOVËS!

## KONKURS

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës shpall konkurs për pranimin e një (1) kadeti në Forcën e Sigurisë i cili do të studiojë në Akademinë Ushtarake, përkatësisht në Universitetin e Zagrebit të Republikës së Kroacisë.

Studimet do të zhvillohen në gjuhën kroate në programin: **Lidershipi dhe Menaxhimi Ushtarak**.  
Konkursi do të jetë i hapur prej 16 deri më 24 prill 2018.

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës ju shërben të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe mirëpret aplikacione të femrave dhe meshkujve për kadetë të FSK-së, pa dallim përkatësie etnike.



Dokumentet duhet të dorëzohen personalisht.  
Aplikacionet mund të dorëzohen në të gjitha kazermat e FSK-së, çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00.  
Kontaktet: [www.mksf-rks.org](http://www.mksf-rks.org), 038- 603-355/199.